

Kumbona e së Diellës



Papa Gjon Pali II (1978 - 2005)

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.5/6, Maj - Qershor 2020

JEMI TË FTUAR QË “TA PËRQAFOJMË” EKOSISTEMIT TONË!

Dita e Tokës 2020
(Earth Day 2020)

Pesëdhjetë vjet më përpara, në vitin 1970, u caktua Dita Botërore e Tokës nxitur nga OKB-ja.

Dita Botërore e Tokës, lindi për të vënë në dukje nevojën e ruajtjes së burimeve natyrore të Planetit dhe, me kalimin e kohës, Dita e Tokës u bë edhe një ngjarje edukative dhe informative.

Ajo bazohet në parimin që të gjithë, pavarësisht prej etnisë, gjinisë, zonës se ku jeton apo gjendjes ekonomike, kanë të drejtën etike për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm, të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm.

Dita e Tokës 2020 merr një domethënie të veçantë, pasi bie pikërisht në momentin e përhapjes më të madhe globale të pandemisë Covid-19. Pra, nëse nga njëra anë nuk do të jetë e mundur që të organizohen manifestime, marshime dhe koncerte live, që zakonisht organizoheshin në vende të ndryshme të botës, nga ana tjetër krenimi i kësaj dite në këtë kohë merr një domethënie të veçantë: atë të marrëdhënies mes njeriut dhe Natyrës, në çdo formë të saj, nga më e madhja deri te më e vogla dhe e padukshmja, siç është, në këtë rast, virusi.

Paradoksalisht, jemi të ftuar që “ta përqafojmë” dhe ta pranojmë edhe këtë virus si pjesë të ekosistemit tonë dhe të fillojmë të mendojmë se, ndoshta, e vetmja mënyrë për ta fituar sfidën vdekjeprurëse të saj, është ndryshimi i zakoneve tona dhe i mënyrës së jetesës, me stile më të shëndetshme dhe zakone e sjellje të frymëzuara më

shumë prej normave higjieno-sanitare që gjithmonë, dhe jo vetëm në këtë rast, do të na bënin mirë t'i kishim dhe t'i respektonim.

Pastaj, si të krishterë, nuk duhet ta harrojmë mësimin e Shën Palit në lidhje me vuajtjen e krijimit, në të cilën edhe ne marrim pjesë, në pritje të përmbushjes së shëlbimit (krh. Rom 8, 22). Ne e dimë se çfarë roli kemi në histori në lidhje me bërjen aktual të shëlbimit të Krishtit.

Pra, kemi një përgjegjësi të madhe, një detyrë të mrekullueshme që sot më shumë se kurrë na thërret si në terma angazhimi moral, nëpërmjet bërjes së zgjedhjeve të qëndrueshme për mjedisin, ashtu edhe në terma shpirtërorë, aty ku, nëpërmjet lutjes, mund t'ia kthejmë Krijuesit vendin e parë në çdo zgjedhje që bëjmë dhe ta shohim veten e krejt krijimin me sytë e Hyjit Atë Dashuri dhe Atë i mirë e provanor.

Ditë të mirë të Tokës të gjithëve.

Shkodër, më 22.04.2020

† Angelo Massafra O.F.M

Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult
Anëtar i Komisionit Shoqëror CCEE
për ruajtjen e Krijimit





Austen Ivereigh KËSHTU PO E JETOJ EMERGJENCËN E PANDEMISË	4
†Angelo Massafra O.F.M. MESHTARI ËSHTË LAJMËTARI I HYJIT	7
Don Lush Gjergji IN MEMORIAM: IMZOT LUCJAN AVGUSTINI	8
Don Nosh Gjolaj NDIKIMI SOCIAL SI DHE TERAPIA GRUPALE	11
Moter Marjeta Gjoka VIRTYTET E ZOJËS SË BEKUAR	14
Giovanni Cucci S.I MELANKOLITË E REJA	17
Federico Lombardi TË VDESËSH NË ZOTIN	20
Motër Marjana Ndrecaj TË DOBËT, POR NË DUART E ZOTIT!	21
Konferenca Ipeshkvore RËNDËSIA E JETËS DHE E SHËNDETIT	22
Mons. Angelo Massafra ËSHTË NJË DETYRË NDAJ TË SËMURËVE	24
Mons. Angelo Massafra PËR RIFILLIMIN E KREMTIMEVE	25
Mons. Angelo Massafra MOTËR RAIMONDINA	26
Mons. George Frendo TË BASHKOHEMI SHPIRTËRISHT	27
VITRINA E LIBRIT	28

KUMBONA E SË DIELLËS
Viti XXXIII, nr. 5/6 (531-532) Maj - Qershor 2020

<u>Revistë</u> Fetaro-Kulturore <u>Drejtues</u> Imzot Angelo MASSAFRA	<u>Redaksia</u> Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor) Dom Vlash Palaj Dom Gjovalin Simoni	<u>Adresa:</u> Arqipeshkvia Shkodër Sheshi Gjon Pali II Tel. 0222-42764 Fax. 0222-43673 e-mail: n_ukgjini@yahoo.it Web page: kishakatolikeshkoder.com
--	---	--

Redaktor teknik: Xhon Nika

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

PAPA: KËSHTU PO E JETOJ EMERGJENCËN E PANDEMISË

Si po e jeton Papa krizën e shkaktuar nga Covid-19? E përgatitjen për më pas? Intervistë e Françeskut realizuar nga Austen Ivereigh. R. SH. – Vatikan, 08 prill 2020.

Si po e jeton Papa krizën e shkaktuar nga Covid-19? E përgatitjen për më pas? Intervistë e jashtëzakonshme e Papës kjo, dhënë në distancë, duke i regjistruar në audio pyetjet e gazetarit dhe shkrimtarit britanik Austen Ivereigh. Intervista u publikua njëkohësisht nga The Tablet (Londër) e Commonweal (New York). ABC ofron tekstin original në spanjisht e Civiltà Cattolica, atë në italisht.

Pyetja e parë drejtuar Papës ishte: “Si po jeton pandeminë e izolimin?”

“Kuria - shpjegoi Françesku - përpiket të vijoje punën, të jetojë normalisht, duke organizuar turne, që të mos grumbullohen shumë njerëz njëherësh. Mendim i mirë, ky. Zbatojmë rregullat e caktuara nga autoritetet shëndetësore. Për këtë arsye edhe për drekën kemi dy turne. Secili punon në zyrë të vet, ose nga shtëpia. Të gjithë janë në punë. Askush nuk rri me duar kryq.

Si po e jetoj unë shpirtërisht? Lutem më shumë, ngaqë besoj se duhet ta bëj këtë. E mendoj për njerëzit, sepse më shqetëson fati i tyre! Mendimi për njerëzit më ngushëllon, më bën mirë, më shkëput nga mendimet vetëm për vete. Të martën vjen rrëfyesi e atëhere i vë në rregull këto lloj mendimesh. Mendoj shumë edhe për përgjegjësitë

e mia aktuale, për sot e për kohët që do të vijnë. Cili do të jetë shërbimi im, si Ipeshkëv i Romës e Kyetar i Kishës, në vijim? Ky vijim ka nisur tashmë të duket tragjik e i dhimbshëm, prandaj për të duhet menduar që sot. Dikasteri për Zhvillimin e gjithanshëm njerëzor organizoi një komision, që punon për këtë e takohet vazhdimisht me mua.

Shqetësimi im më i madh - që e ndjej fort sidomos gjatë lutjes - është si duhet shoqëruar populli i Zotit e si mund t'i qëndroj sa më pranë. Këtë kuptim ka edhe Mesha e orës 7.00 të mëngjesit në live streaming, që ndiqet nga shumë njerëz, të cilët ndjehen të shoqëruar, ashtu edhe disa nga fjalët e mia si dhe riti i 27 marsit në Sheshin e Shën Pjetrit. Është punë e vazhdueshme pranie, përmes Lëmoshtarisë Apostolike, për t'i shoqëruar njerëzit në këtë situatë urie e sëmundjeje. Po e jetoj me shumë paqartësi këtë çast. Çast, që kërkon frymë të veçantë krijuese!

Në pyetjen e dytë Auszten Ivereigh kujton romanin “Të Fejuarit” të Alessandro Manzoni, ngjarjet e të cilat zhvillohen në kohën e kolerës, që u përhap në Milano në vitin 1630, në të cilin përshkruhen njerëz të Kishës me qëndrime tejet të ndryshme. E, prej këndej, pyet si e shikon Papa misionin e Kishës në këtë çast?



“Kardinali Federigo - përgjigjet Françesku - është hero i vërtetë i kolerës së Milanos. Por, në njërin nga kapituj tregohet sesi ai kalonte duke i përshëndetur njerëzit i mbyllur në lektigë, ndoshta pas ndonjë dritareje, për t'u mbrojtur. Populli mbetet keq, sepse e donte bariun sa më pranë e nuk i pëlqen ta shikojë duke e mbrojtur veten në tepri. Sot populli ka nevojë ta ndjejë bariun sa më pranë, me vetmohimin e kapuçinëve, që nuk pyesnin fare për kolerë.

I krishteri duhet të jetë krijues, të hapë horizonte të reja, dritare të reja, rrugë të reja drejt Zotit e drejt njerëzve. E duhet të jetojë në një mënyrë të re edhe në shtëpi. Sepse nuk është e lehtë të mbyllesh brenda katër mureve. Më kujtohet një varg i Eneides që, në rrethanat e humbjes së betejës, i këshillon luftëtarët të mos i ulin krahët. Përgatituni, prandaj, për kohë më të mira, duke kujtuar gjërat që ndodhin sot! Kujdesuni që tani, për kohët që do të vijnë. E kur të vijnë, do t'ju bëjë mirë të kujtoni atë që ndodhi. Kini kujdes për të sotmen, por me vështrimin drejt ardhmërisë. Me frymë krijuese. Me krjimtari të thjeshtë, që shpik çdo ditë diçka të re. Në familje nuk është vështirë të krijosh. Po nuk duhet ikur, në këtë kohë, nuk duhen kërkuar rrugë të tjera.

Pyetja e tretë lidhej me politikën, që po vënë në jetë qeveritë, si përgjigje që i jepet krizës:

“Disa qeveri - kujton Papa - morën masa shembullore, me detyra të dorës së parë të mirëmbledhura, për ta mbrojtur sa më shumë e më mirë popullsinë. Por po shikojmë edhe se i gjithë mendimi ynë, na pëlqen apo jo, po rrotullohet gjithnjë rreth ekonomisë. Mund të thuhet se në botën financiare të sakrifikosh duket si gjë krejt normale. E kjo është thjesht kultura e hedhurinës. Prej kreut, deri në fund! E kështu edhe kultura e eutanazisë, legale a e fshehtë qoftë, ajo që të moshuarave ua jep ilaçet deri një farë pike. Mendoj



për enciklikën e Palit VI, për Humanae Vitae. Kur flitej për pilulën, e Pali VI paralajmëronte valën e neomaltuzianizmit, që sot e shikojmë në seleksionimin e njerëzve, sipas mundësisë për të prodhuar, për të qenë të nevojshëm: e kjo është kultura e hedhurinës! Të pastrehët mbeten të pastrehë! I pashë këto ditë në një fotografi, në Las Vegas, të vënë në karantinë në mes të një parku. Sepse i pastrehi nuk mund të shkojë në hotel. Edhe kur hotelet janë bosh! E këtu shihet qartë teoria e hedhurinës!”.

Së fundi gazetari e pyeti Françeskun si mund të jetohej këto Kreshmë e këto Pashkë kaq të jashtëzakonshme. I kërkoi edhe një mesazh të posaçëm për pleqtë e izoluar, të rinjtë e mbyllur në shtëpi e për të gjithë ata, që vijojnë të varfërohen për shkak të krizës:

“Ju po më flisni për pleqtë e izoluar. Jetojnë në vetmi e distancë. Sa pleq -u përgjigj Françesku - kanë fëmijë, që nuk shkojnë t'i shikojnë as në kohë normale! Më kujtohet, në Buenos Ajres, kur vizitoja shtëpitë e pleqve e pyesja si shkonin punët në familje. “Ah, mirë, mirë fort” - gjegjeshin. “Po vjen kush t'ju vizitojë?”. “Vijnë, vijnë, gjithnjë”. Pastaj infermierja më thoshte se kishin kaluar gjashtë muaj nga koha kur fëmijët e tyre qenë dukur në këtë vend, ku i kishin mbyllur prindërit. Në vetmi, braktisje, larg nga gjithkush e nga gjithçka dëshironin. E kjo, edhe pse të moshuarit vijojnë të jenë rrënjët e të rinjve. E i riu ka gjithnjë nevojë për rrënjë, edhe kur është plot me gjethe të gjelbërta. Po rrënjët i duhen. Ndryshe nuk mund të japë fryte.

Njerëzit, që u varfëruan nga kriza, janë të mashtruarit e sotëm, që u shtohen të “zhveshurve” të përhershëm. Ç'kuptim ka sot humbja e gjithçkaje, parë në dritën e Ungjillit? Ungjilli na kujton se duhet të hyjmë në botën e tyre, ta kuptojmë atë, që deri dje kishte, e sot nuk ka më asgjë. Këtë u kërkoj njerëzve: të kujdesen për pleqtë e të rinjtë. Të përgjigjen për këta njerëz, që nuk kanë tjetër gjë, veç shpirtit.

E kjo më kujton një varg të Virgjilit: çastin kur Enea i mundur në Trojë, humbi gjithçka e i mbetën vetëm dy rrugëdalje: o të rrinte aty duke dënesur e t'i jepte fund jetës, ose të bënte çka ia donte zemra, të ikte në mal, për t'u larguar nga lufta. Një varg domethënës: “U dorëzova e, si e mora mbi shpinë tim atë, u nisa kah malet”. Është ajo, që duhet të bëjmë të gjithë sot: të marrim rrënjët e traditave tona e të ngjitemi mbi male”. Domethënë, në kërkim të rrugëve të reja!

MESHTARI ËSHTË LAJMËTARI I HYJIT MES NJERËZVE

Cilësinë e dytë mund ta përmbledhim kështu: Meshtari është njeri i Eukaristisë dhe i Liturgjisë

Homelia e Meshës krizmale
Shkodër, 29/05/2020

Shumë të dashur vëllezër në meshtari dhe ju besimtarë të gjithë, që, me kujdesin e duhur për shkak të pandemisë prej COVID-19, keni dashur të qëndroni afër ipeshkvit dhe meshtarëve tuaj në këtë ditë ku përkujtojmë Krishtin që u jep Apostujve dhe të gjithëve ne meshtarinë e vet, ta jetojmë këtë kremtim me ndjenja lavdi dhe falënderimi për mundësinë konkrete se po përjetojmë sërish bashkë, fizikisht, faktin që jemi populli i shenjtë i Hyjit.

Jemi një popull, një mbretëri dhe meshtarë që Krishti ka krijuar *“për Hyjin dhe Atin e Vet”*: e kemi dëgjuar në leximin e dytë, gati si përgjigje ndaj atij hapi tjetër që kemi shpallur në leximin e parë: *“kurse ju do të quheni “Priftërinjtë e Zotit”, ju do t’ju emërtojnë Shërbëtorët e Hyjit tonë”* (Is 61,6).

Dhe nëse kjo është e vërtetë për totalitetin e trupit mistik të Krishtit, Koka dhe gjymtyrët së bashku, është e vërtetë edhe, sipas mësimit të Shën Palit, që në dëgjesë ndaj lëvizjeve të Shpirtit Shenjt, secili brenda këtij trupi kryen një detyrë që është e vetja, që rrjedh prej dhuratës së marrë dhe që jetohej në mbarështrim, shërbim.

Mes këtyre detyrave është ajo e meshtarit, në përgjigje të një thirrjeje të veçantë që ka si mision mishërimin e Krishtit Bari i mirë, që gjallëron dhe udhëheq popullin e Hyjit. Në meshtari realizohen fjalët e profetit që Jezusi ia vesh vetes në sinagogën e Nazaretit: *“Shpirti i Zotit është mbi mua”* dhe *“Sot shkoj në vend kjo pjesë e Shkrimit shenjtë”* (Lk 4, 18.20).

Po kush është meshtari? Në këtë reflektim dëshiroj të bashkëndaj me ju përmbajtjen e një letre, atë që Papa Benedikti XVI ua drejtoi meshtarëve dhjetë vjet më parë: Meshtari është lajmëtar i Hyjit mes njerëzve. Janë reflektime që mund të na bëjnë mirë ne meshtarëve që i dëgjojmë dhe popullit të Hyjit, sepse, në kuptimin e ndërsjellë mund të rritemi si trup mistik i Krishtit.

Papa emerit, pasi ka treguar për thirrjen e vet meshtarake në një kontekst si ai i pas-Luftës së Dytë Botërore, ku parashikohej se do të kishte pasur shumë nevojë për meshtarë, ashtu siç ndodh edhe sot në epokën tonë të globalizuar, ku ka nevojë për atë që e çon nëpër botë *“Hyjin që është shfaqur*

në Jezu Krishtin dhe që na mbledh në Kishën e gjithëmbarshme, për të mësuar prej Tij e përmes Tij jetën e vërtetë dhe për t’i mbajtur gjallë dhe për t’i bërë të efektshme kriteret e njerëzisë së vërtetë”. Dhe Papa Benedikti thotë: *“Hyji jeton, dhe ka nevojë për njerëz që të ekzistojnë për Të dhe që T’ua çojnë Atë të tjerëve. Po, ka kuptim të bëhemi dhe të jemi meshtarë: bota ka nevojë për meshtarë, për barinj, sot, nesër e përgjithmonë, derisa ajo të ekzistojë”*.

Pastaj liston gjashtë cilësi të meshtarit.

Cilësia e parë: *“Meshtari, duhet të jetë para së gjithash ‘njeri i Zotit’”*. *“Për ne Hyji nuk është një hipotezë e largët, nuk është një i panjohur që është tërhequr pas ‘big bang-ut. Hyji është shfaqur në Jezu Krishtin. Në fytyrën e Jezu Krishtit shohim fytyrën e Hyjit. Në fjalët e Tij ndiejmë se është vetë Hyji Ai që flet me ne. Për këtë arsye gjëja më e rëndësishme gjatë gjithë jetës meshtarake është marrëdhënia personale me Hyjin në Jezu Krishtin. Meshtari nuk është administruesi i një shoqate çfarëdo, numrin e anëtarëve të së cilës ai duhet ta mbajë dhe ta shtojë. Është lajmëtar i Hyjit mes njerëzve. Dëshiron t’i çojë njerëzit te Hyji dhe kështu të rrisë edhe bashkësinë e vërtetë të tyre me njëri-tjetrin. Për këtë arsye, të dashur miq, është kaq e rëndësishme që të mësoni të jetoni në kontakt të vazhdueshëm me Hyjin. Kur Zoti thotë: ‘Lutuni në çdo moment’, është e kuptueshme që nuk po na kërkon që të themi lutje vazhdimisht, por që të mos e humbasim kurrë kontaktin e brendshëm me Hyjin. Ushtrimi në këtë kontakt është domethënia e lutjes sonë. Për këtë arsye është e rëndësishme që dita të fillojë dhe të mbarojë me lutje, që ta dëgjojmë Hyjin në leximet e Shkrimit të shenjtë, që t’ia themi dëshirat dhe shpresat tona, gëzimet dhe vuajtjet tona, gabimet dhe falënderimet tona për çdo gjë të bukur e të mirë dhe kështu e kemi gjithmonë përpara syve si pikë referimi të jetës sonë. Kështu bëhemi të ndjeshëm si për krejt të bukurën dhe të mirën që marrim dhe që bëjmë çdo ditë, ashtu bëhemi të ndjeshëm edhe për gabimet tona dhe mësojmë të punojmë për t’u përmirësuar”*.

Cilësinë e dytë mund ta përmbledhim kështu: Meshtari është njeri i Eukaristisë dhe i Liturgjisë. Dhe Benedikti thotë: *“Hyji nuk është vetëm një fjalë për ne. Në Sakramente Ai na jep vetë Vetën e Vet, përmes gjërash trupore. Qendra e marrëdhënies sonë me Hyjin dhe e formës së jetës sonë është*

Eukaristia. Kremtimi i saj me pjesëmarrje të brendshme dhe të takuarit me vetë Krishtin, duhet të jetë qendra e çdo dite. Krishti i ngjallur, që na dhurohet neve në Eukaristi, e plazmofte me të vërtetë krejt jetën tonë me shkëlqimin e dashurisë së Tij hyjnore. Për një kremtim siç duhet eukaristik, është e nevojshme të mësojmë edhe që ta njohim, ta kuptojmë dhe ta duam liturgjinë e Kishës në formën e saj



konkrete. Në liturgji lutemi së bashku me vëllezërit e të gjithë shekujve – e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja bashkohen në një kor të vetëm lutjeje.

Cilësia e tretë e përshkruan meshtarin si “njeri i Pendësës”. “Edhe sakramenti i Pendësës është i rëndësishëm”, thotë Papa Benedikti. “Më mëson që ta shoh veten nga këndvështrimi i Hyjit dhe më detyron që të jem i ndershëm me veten time. Më çon drejt përvujtësisë. Është e rëndësishme që të ec gjithë kohën, pa skrupolozitet, me vetëdijen mirënjohëse që Hyji më fal çdo herë, por edhe pa indiferencë, që nuk do të na bënte më që të luftonim për shenjtëri dhe përmirësim. Dhe , duke e lënë veten që tjetri të më falë, do të mësoj që edhe unë t'i fal të tjerët. Duke njohur mjerimin tim, bëhem edhe më tolerant dhe më mirëkuptues ndaj dobësive të të afërmit tim”.

Cilësia e katërt është ajo e studimit: “Feja e krishterë ka një përmasë racionale dhe intelektuale, që është thelbësore për të. Ju të gjithë e njihni fjalën e Shën Pjetrit: 'Jini gjithmonë të gatshëm t'i jepni përgjigje gjithsecilit që prej jush kërkon arsyen e shpresës që është në ju' (1 Pjt 3,15). Po jua përsëris: duqjeni studimin e teologjisë”.

Cilësia e pestë dëshiron që meshtari të jetë njeri njerëzisht i ndershëm. Dhe e shpjegon me këto fjalë: “Për meshtarin, i cili duhet të shoqërojë të tjerë përgjatë ecjes së jetës dhe deri te dera e vdekjes, është e rëndësishme që ai vetë të ketë vënë në një ekuilibër të drejtë zemrën dhe intelektin, arsyen dhe ndjenjën, trupin dhe shpirtin, dhe që të jetë njerëzisht 'i ndershëm'. Tradita e krishterë gjithmonë i ka lidhur me 'tre virtytet teologale' edhe 'katër virtytet themelore', Pali ua thotë Filipianëve në mënyrë shumë të qartë: 'Së fundi, o vëllezër, mundohuni të keni për zemër gjithçka është e vërtetë, gjithçka është e ndershme, gjithçka është e drejtë, gjithçka është e pastër, gjithçka është e shenjtë, gjithçka është e denjë për dashuri, gjithçka

është e denjë për lavdi, gjithçka është virtyt' (Fil 4,8). Është një element thelbësor i ecjes suaj që t'i praktikoni virtytet njëzore themelore, me shikimin e drejtuar kah Hyji i shfaqur në Krishtin, dhe ta lini veten, përherë, që të pastroheni prej Tij”.

Cilësia e fundit e sheh meshtarin si “njeri i aftë për vëllazëri”. “Përvoja e vëllazërisë së jetuar gjatë viteve të seminarit, ju ndihmoftë që ta jetoni sot vëllazërinë meshtarake. Gjatë të jetuarit së bashku, ndoshta ndonjëherë i vështirë, duhet të mësoni bujarinë dhe tolerancën jo vetëm për ta duruar njëri-tjetrin, por për ta pasuruar njëri-tjetrin, në mënyrë që secili t'i bashkëndajë me të tjerët dhuntitë e tij të veçanta, ndërsa të gjithë i shërbejnë të njëjtës Kishë, të njëjtit Zot”.

Kjo është bashkëndarja ime për këtë Meshë Krizmale: mendime të thjeshta, por në të njëjtën kohë të pasura me vlera për atë që, lirisht, ia ka dhuruar jetën e vet Hyjit dhe Kishës së Tij. Të kujtojmë se jemi në Kishë dhe për Kishën, me gjithçka që kjo mbart në terma shërbimi dhe jo pushteti, ashtu siç i pëlqen Papa Françeskut të na e përsërisë shpesh; në terma gjallëruesish shenjtërie në mesin e popullit që na është besuar dhe që udhëheqim jo në emrin tonë, por në emër të Atij që na ka caktuar barinj.

Dhe ju, o popull i Hyjit, mos harroni kurrë që të luteni për meshtarët tuaj, ashtu si ata çdo ditë luten për secilin prej jush në altar, gjatë flisë së Meshës së shenjtë.

Po e përfundoj me vetë fjalët e Papa Benediktit në mbyllje të Letrës së tij: të dashur meshtarë, “*Ja besoj Meshtarinë tuaj mbrojtjes amënore të Marisë shumë të Shenjtë. Ju bekoftë Hyji i gjithëpushtetshëm, Ati e Biri e Shpirti Shenjt*”. Amen.

† **Angelo Massafra O.F.M.**

Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult

Don Lush GJERGJI

BARI I URATËS, PËRSHPIRTËRISË DHE KOMUNIKIMIT ME NJERËZ

In memoriam: Imzot Lucjan Avgustini (1963-2016)

1. Jeta

Pas një sëmundjes së rëndë dhe të shkurtë kaloi në amshim Imzot Lucjan Avgustini (22 maj 2016), ipeshkvi i Sapës. Ai ka lindur në Ferizaj më 23 gusht 1963, biri i Gjinit dhe Roza lind. Gjergji – Avgustini, që kanë pasur 10 fëmijë, si familje e mirë dhe e bekuar. Pagëzimin e mori po ashtu në Ferizaj, në kishën “Engjëlli Rojës” nga Imzot Smiljan Franjo Čekada, ipeshkëvi i atëhershëm i Shkupit, më 5 shtator 1963. Kjo datë dhe ditë simbolike dhe e shënuar për ne, por edhe për mbarë botën, na përkujton ditë e “kthimit në shtëpinë e Atit” e së Lumes Nënës Tereze, që në një mënyrë paralajmëron se edhe jeta e Imzot Lucjanit do të jetë ngushtë e lidhur me këtë emër: me thirrjen dhe shërbimin e tij meshtarak, me njohjen e saj personale, me katedralen e Vau Dejës, që bart titullin “Nëna Tereze”.

Shkollën fillore e kreun në vendlindje, ku ishte ministrat i rregullt, së bashku me Dodë Gjergjin, tani Ipeshkvin e Kosovës. Pasi kreu shkollën tetëvjeçare, një mbrëmje e vizitova në gjirin familjar. Ndër të tjera i thashë: “Driton, (kështu e kam quajtur gjithnjë duke shqiptuar emrin e tij, vr. ime), “tash e kreu shkollën tetëvjeçare. Urime! Besoj se do ta vazhdosësh shkollimin... Por çka dhe ku ende nuk e di... Pra, më trego!”. Ai, sadopak me marre, i skuqur, më tha: “Do të bëhem Don Lush!”.

Të gjithë qeshëm në këtë përgjigje. Unë, për ta nxjerrë nga kjo situatë, vazhdova: “Driton, nëse Zoti do, të do të bëhesh Don Lucjan – Driton, e jo Don Lush”.

Ashtu edhe ndodhi. Së bashku me Dodë Gjergjin u paraqiten për seminar në Suboticë “Paulinum”, ku përfunduan me sukses shkollën e mesme. Fakultetin filozofik – teologjik në Zagreb e kryen me sukses dhe sjellje të mirë, gjithnjë së bashku.

Më 15 gusht 1989 Imzot Nikë Prela i shuguroi meshtarë, duke treguar me dorë, fjalë dhe zemër se po i shuguronte për “Shqipërinë martire!”. Profetizoi. Ditë e shënuar dhe e paharruar, kur besimtarët tanë ishin të tronditur nga kjo ngjarje, shumë prej tyre edhe të frikësuar, si Ipeshkvi ynë haptazi e përmendi Shqipërinë, lirinë fetare dhe demokracinë, atëherë kur edhe ne ishim “në gojë të ujkut”, siç thotë populli.

Më 10 shtator 1989 caktohet bashkëpunëtor i

shtëpisë botuese “DRITA”, për punë të botimeve liturgjike, por edhe ndihmonte Imzot Nikë Prelën si ushtrues detyre të sekretarit personal. Ishte i palodhshëm dhe shumë i vullnetshëm për jetën dhe shërbimin meshtarak. Shpesh të dielave dhe festave e ndihmonte famullitarin e Stubllës, tash Imzot Rrok Gjonleshaj, argjipeshkvin e ri të Tivarit. Zelli, vullneti, dëshira, entuziazmi i tij rinor vërtet ishte i dukshëm dhe shembullor.

Pas kurorëzimit të punës së suksesshme në botimin e “Mesharit Romak”, (1992), më vonë edhe botimin e Biblës complete në gjuhën shqipe, për herë të parë nga Kisha katolike (1994), fushëveprimi rritej dhe begatohej.

Përfundimi i kësaj pune të lodhshme dhe përvojë baritore dhe botuese, e bënë Don Lucjan Avgustinin të përshtatshëm të emërohet drejtor i parë i Caritasit të Kosovës, ndërsa më 15 prill 1993, edhe famullitar i Ferizajit, ku shërbeu me zell dhe përkushtim deri në nëntor të vitit 1994.

Shqipëria tashmë ishte hapur dhe bënte hapat e parë në liri dhe demokraci. Mungesa e klerit, kishave, shtëpive të famullive, ishin frymëzim për Don Lucjan Avgustini, së bashku me Don Dodë Gjergjin, që shprehin dëshirën dhe gatishmërinë për ta ndihmuar Kishën katolike në Shqipëri me shërbimin e tyre meshtarak.

Më 27 tetor 1994 me dekretin 501/94 Lucjan Avgustini qe liruar nga detyrat në ipeshkvin Shkup-Prizren, për të qenë i lirë si “Fidei donim” (Dhuratë feje) në argjipeshkvinë e Shkodrës.

Aty, së pari ishte ndihmës-famullitar, kurse më 14 korrik 1995 emërohet famullitar i katedrales “Shën Shtjefni” në Shkodër. Puna dhe veprimtaria ishte e paskajshme, por edhe feja dhe dashuria e Don Lucjanit, përballonin çështje tejet të vështira dhe shumë sfiduese.

Më 24 maj 1997 nga Papa Shën Gjoni Pali II qe emëruar nga “Kapelani i tij”, me titull të lartë të nderit – Monsinior.

Imzot Lucjan Avgustini, edhe pse i ri në moshë, por i rryer në jetë dhe përvojë meshtarake, Ati i Shenjtë Benedikti XVI emëroi Ipeshkëvi të Sapës në Shqipëri, për ta zëvendësuar Imzot Dodë Gjergjin, që ishte caktuar Ipeshkëvi i Kosovës (12 dhjetor 2006).

Imzot Lucjan Avgustini ishte njeri i pendës dhe punës, mbi të gjitha i uratës, përshpirtërisë dhe

komunikimit me njerëz, besimtarë, për t'i dëgjuar, këshilluar, udhëzuar, për t'iu thënë një fjalë të mirë, për t'ua dhënë përvojën e fesë dhe begatinë e dashurisë së krishterë. Ishte apostull i vërtetë në çdo fushëveprim, zelltar i pashoq, vullnetar i palodhshëm, dëshmitar dhe predikues i Krishtit dhe Ungjillit të tij. Për të koha ishte dhuratë, hir, pasuri për t'u ndarë dhe dhuruar të gjithëve.

Si ta kishte një lloj parandjenje se “koha” po e ngute, mos të them po e “përndjekte” hap pas hapi, si në ndonjë lloj vrapimi, përsheptim kah amshimi.

2. Dëshmia – veprimtaria

Çka të cekim dhe dallojmë nga veprimtaria e Imzot Lucjan Avgustit? Shumëka, edhe pse jeta e tij tokësore ishte e shkurtë, gjithsejtë 53 vjeçare. Megjithëse atë ai ka lënë shenja dhe gjurma të pashlyeshme në kujtimet dhe zemrat e njerëzve kudo, në Ferizaj, në Shkodër, në Vau Dejë, në viset e ndryshme shqiptare, por edhe në vende të ndryshme të botës.

Ajo që binte në sy ishte qetësia, gëzimi, hareja, lumturia, vullneti për jetë dhe punë, komunikimi në vazhdimësi. Gjatë jetës pati detyra të vështira dhe me shumë përgjegjësi, në një kohë “pa kohë”. Po i përmendi vetëm disa:

– Shenjtërorja e Zojës së Shkodrës, Pajtores së Kishës dhe Popullit Shqiptar, si dhe të gjitha objektet dhe subjektet në Shqipëri, kishin nevojë për rindërtim dhe meremetim rrënjësor, pas rrënimave komuniste dhe ateiste. Imzot Lucjan Avgustini i ka udhëheq punimet në këtë Shenjtërore, dhe nga viti 1998, ishte përgjegjës shpirtëror dhe baritor i të njëjtës shenjtërore.

– Si famullitar i katedrales së Shkodrës ka udhëhequr punimet dhe përfunduar ndërtimin e kambanarës së kësaj Katedrale. Po ashtu ishte përgjegjës edhe për ndërtimin e kishës së re në Hot të Ri. Mirëpo punët rreth ndërtimit atë kurrë nuk e kanë ndarë prej punës baritore, prej shkrimit dhe leximit, studimit, prej jetës dhe veprimtarisë meshtarake.

– Kjo më së miri është dëshmuar edhe me angazhimin e tij në Institutin Kateistik të



Shkodrës që nga viti 1994, ku ishte dalluar si mësimdhënës dhe pedagog i shquar dhe tejet i dalluar. Ligjëratat e Don Lucjan Avgustinit ende përkujtohet me shumë nderim dhe falënderim, mbi të gjitha me fe dhe dashuri.

– Viti 1997 për Shqipërinë demokratike ishte sfidë tejet e madhe dhe shumë e rrezikshme. “Flisnin armët”, grupet dhe grupacionet, mbi të gjitha urrejtja e akumuluar tashmë me dekada. Njerëzit mendonin se ka ardhur koha për ta “ndarë” drejtësinë, për ta marrë pushtetin në dorë. Besimtarët, ndër ata, edhe të krishterët, ishin të hutuar, të frikësuar dhe të habitur. Mungonte ndonjë zë me autoritet. Don Lucjan Avgustini, së bashku me përfaqësuesit e dy komuniteteve tjera në Shkodër, doli në pah dhe ka kontribuar shumë për paqen dhe përmirësimin e gjendjes tejet të vështirë pas trazirave të marsit të njëjtë vit. Ai guximisht dhe heroikisht iu kundërvu së keqes, urrejtjes, dhunës së verbët, me fjalë, mësim, qortim, edhe më shumë me jetë dhe me shembull. Për këtë kontribut, Këshilli i Bashkisë Shkodër e nderon me titullin “Qytetar nderi” i qytetit të Shkodrës.

– Vitet 1998 – 1999 ishin sfida më e madhe për Kosovës, bile edhe për bashkësinë ndërkombëtare. Afro 1 milion njerëz ishin të shvendosur në Maqedoni, Shqipëri, Mal të Zi, kudo në botë... Dukej egzodi biblik... Don Lucjan Avgustini, me bashkëpunëtorë të Caritasi të Shkodrës, angazhohet për pritjen, kujdesin, strehimin dhe sistemimin e të larguarve me dhunë nga Kosova, diku afro 8000.

– Një ndër fushëveprimet e tij të dalluara ishte pa dyshim mbrojtja e jetës në të gjitha fazat, nga ngizja dhe shtatzënia, deri te vdekja e natyrshme.

Shi për këtë ishte anëtar aktiv i “Lëvizjes për jetën”, duke e luftuar vendosmërisht abortin, dështimin, dhe moskujdesin ndaj të sëmureve dhe të moshuarve.

– Në këtë stil dhe domethënie ka ndërtuar pranë Residencës Qendrën për të moshuar, për fëmijë me të meta dhe pa kujdes, për nevojtarë dhe të varfër, si “Shtëpia e bëmirisë”, ku Mons. Lucjani ku shërbente me shumë kënaqësi dhe lumturi. Aty përjetonte dhe dëshmore shpirtin e bamirësisë, apo të “Nënës Tereze” si do të thonte ai.

– Ishte ligjërues, konferencier i mirë në vende të ndryshme të botës, duke paraqitur historinë, lashtësinë, martirizimin tonë shekullor, mbi të gjitha tiparet dalluese të krishterimit ilir, arbëror dhe shqiptar.

Nga kjo që shkrova dhe theksova mund të përfundojmë që Imzot Lucjan AVGUSTINI ishte një figure e ndritur dhe complete e meshtarit të Kishës katolike, një Bari – ipeshkëv me zell të madhe baritor, prej të cilit kemi pasur shumë dhurata, karizma dhe virtyte, ndër të cilat spikasin feja e gjallë dhe vepruese, shpresa e fortë dhe e pathyeshme, në çdo kushte dhe rrethanë, mbi të gjitha dashuria flijuese dhe dhuruese për Zotin, Kishën, Njeriun.

Mirëpo atëherë kur pritej prej Imzot Lucjan Avgustinit më së shumti, iu ndërpre ecja, hovi, vazhdimi. Zoti e thirri nga kjo jetë në amshim. Përse dhe si, vetëm Ai e di, Ne na mbesin shumë kujtime dhe përjetime të bukura, ungjillore, shumë vepra që do të përmenden dhe s'do të harrohen. Na mbetet feja dhe urata si komunikim me Zotin, nëpërmjet Tij, me Imzot Lucjan Avgustini, me të parët tanë që na prijnë në amshim.

3. Nga Fjala e Imzot Lucjan Avgustinit pas shugurimit ipeshkvor

Për të “shijuar” figurën dhe personalitetin e Imzot Lucjan Avgustinit, ia disa fjalë dhe mendime nga fjala e rastit pas shugurimit ipeshkvor (5 janar 2007):

“Me njoftimin e parë se Ati i Shenjtë Benedikti XVI më ka zgjedhur që të jem ipeshkëv, më ra ndër mend thirrja e Jeremisë profet dhe përgjigja e tij se është fëmijë dhe se nuk din të flet, e Zoti u përgjigj: “Mos thuaj jam fëmijë. Por shko te të gjithë ata që të dërgoj... mos ki kurrfarë frike, sepse unë jam me Ty...”

Të jesh ipeshkëv do të thotë thirrje për të dëftuar Jezu Krishtin dhe për ta shpallur mësimin e tij. Kjo thirrje nuk më largon nga populli, por përkundrazi më mundëson dhe kërkon nga unë që të jem në mes të popullit, për ta mësuar me mësimin e Ungjillit,

për të jetuar në dashuri dhe falje, për ta ushqyer me Korpin e Gjakun e Tij, për t'i qëndruar besnik Krishtit dhe zëvendësit të tij në tokë, Shën Pjetrit dhe pasardhësve të tij, sipas shembullit të parëve dhe martirëve tanë, të cilët edhe para pushkatimit kanë brohorit me zë: Rroftë Krishti Mbret, rroftë Papa, rroftë Shqipëria, i fali ata që më pushkatojnë...

“Ju të dashur meshtarë, rregulltarë dhe rregulltare ju premtoj se do të mundohem të jem në gjithëcka para jush, të ju prij i pari për të mirën e grigjës që na është besuar.

Një falënderim i posaçëm dhe lutje i takon, dritë paçin: Dom Gaspër Gjinit nëpërmjet të cilit Zoti më thirri në meshtari. Ai më ushqeui zemrën dhe mendjen për dashuri ndaj Shqipërisë, atëherë kur këtu gjithëcka ishte e ndaluar, më thoshte “kumar Shqipëria na pret. Aty është derdhë gjaku i martirit tonë Dom Shtjefën Kurti-t”. Me të njëjtin mall dhe respekt kujtoj edhe Imzot Nikë Prelën dhe Imzot Mark Sopin të cilët më mësuan shumë, e mua më mbetet që të lutem për ta...”

“Dëshiroj të ju shprehi mirënjohjen time autoriteteve kishtarë këtu të pranishme, Ju të dashur vëllezër në episkopat, shuguruesin tim Imzot Angelo Massafra, arqipeshkëv i Shkodër-Pulit, me të cilin edhe kam bashkëpunuar me vite si meshtar dhe Vikar gjeneral i dioqezës, dy bashkëshuguruesit Imzot Zef Gashi, arqipeshkëv i Tivarit, Imzot Rrok Mirdita, arqipeshkëv i Tiranë – Durrës, Imzot Dodë Gjergjin ipeshkëv në Kosovë, shokun tim të pandashëm që nga fëmijëria. Falënderoj të gjithë meshtarët, rregulltarët dhe rregulltarët këtu të pranishëm, kisha dashtë që secilin të përmendi me emër dhe të falënderoj për praninë tuaj, mbështetjet me lutje dhe bashkëpunimin në punën baritore. Të gjithëve përzemërsisht iu falënderoj...”

Të falënderoj o Zot për nderin që ma bërë dhe më jep fuqinë dhe urtinë të mundem të punoj në këtë tokë martire, këtë dioqezë që ma besove, po me të njëjtën dashuri dhe flijim sipas shembullit të paraardhësve të mi Budit, Bardhit, Mjedës, Serreqit, Kolecit, Thaqit, Prennushit, Volaj dhe së fundmi Imzot Dodë Gjergjit të cilin posaçërisht e falënderoj për punën e bërë deri sot, për çdo djersë të ballit të derdhur, për çdo mësim këshillë dhe fjalë që ia ka dhuruar kësaj dioqeze për rimëkëmbjen e saj.

Faleminderit të gjithëve të pranishmëve në këtë Kishë dhe jo të pranishmëve që në çfarë do lloj mënyre më përcollët dhe me ndihmuat, me lutje, mësim, këshilla, gëzime dhe vështirësi”

Don Nosh GJOLAJ

Podgoricë

NDIKIMI SOCIAL SI DHE TERAPIA GRUPALE

(fund)

*Përderisa teoria frustrimit - impuls u siguron njerëzve pak më tepër shpresë,
kjo teori thotë se frustracioni çon në zgjimin e një impulsi agresiv për të goditur burimin e frustracionit!*



Drejtuesi social është ai që përpiqet t'i bëjë anëtarët e grupit të jenë të kënaqur nga njëri-tjetri. Ai e mban grupin kompakt, dhe është më i preokupuar për bashkëveprimin social për kryerjen e detyrës. Shpesh grupi do të ketë drejtues të veçantë për detyrën dhe të veçantë për funksionet sociale. Që grupet e qëndrueshme ose grupet nga çiftet martesore t'i realizojnë me sukses qëllimet e tyre afatgjata shpesh kanë nevojë për të dy tip e drejtuesve.

Terapia e grupit është e domosdoshme për shmangien e shumë problemeve që sot i përjeton familja. Një nga këta probleme është edhe agresiviteti njëerës apo tjetrës palë në bashkësinë martesore. Ndërsa agresiviteti është një sjellje, por ai shoqërohet me emocion (zemërim) dhe ndikohet nga motivacioni.

Teoria më e vjetër për agresivitetin thotë se njerëzit janë nga natyra agresivë. Ndoshta mbështetësi më i shquar i teorisë së instinkteve ishte Sigmund Freud, i cili argumentoi se

agresiviteti është rezultat i instinktit të vdekjes (Thanatos) me të cilin lindin të gjitha qeniet njerëzore. Freudi hodhi idenë se energjia shkatërruese zmadhohet dhe duhet të çlirohet përmes sjelljes agresive. Ndërsa sipas Konrad Lorenz, se njerëzit janë agresivë sepse ata kanë evoluar për të mbijetuar. Kafshë të tjera më të fuqishme kanë frenime për të mos dëmtuar njëra-tjetrën. Lorenz argumentoi se meqë një njeri pa armë është mjaft i pafuqishëm përballë të tjerëve, ai nuk mund të ketë frenimet që kanë shumica e llojeve të tjera për t'u ndeshur. Instinkti i agresivitetit i kombinuar me zhvillimin e armës e ka bërë njeriun kafshë më të rrezikshme të natyrës.

Përderisa teoria frustrimit - impuls u siguron njerëzve pak më tepër shpresë. Kjo teori thotë se frustracioni çon në zgjimin e një impulsi agresiv për të goditur burimin e frustracionit. Për shembull, në qoftë se ju doni të bëni një mbrëmje, por shoku martesor i juaj nuk dëshiron, frustracioni juaj mund të çojë në agresivitet ndaj partnerit tuaj. Kjo teori

hodhi idenë se i gjithë agresiviteti është rezultat i frustracionit dhe mënyra për ta kontrolluar atë është eliminimi i frustracioneve të mundshme në mjedis. Për shembull, në qoftë se secili nga ne do të kishte çdo gjë që i nevojitej e çdo gjë që do të donte, gjë që për fat të keq duket krejt e pamundur, atëherë frustracioni nuk do të ekzistonte dhe, për pasojë nuk do të ekzistonte dhe agresiviteti.

Teoria e të mësuarit social thonë se agresiviteti është një formë e sjelljes së mësuar sociale. Studiuesit i vunë fëmijët të shikonin një film me një sulm të të rriturve mbi një kukull të madhe “Bobo”, e cila qëndronte më këmbë. Të rriturit kryenin me kukullën disa sjellje të pazakonshme agresive. Më vonë, kur fëmijët u lejuan të luanin me kukullën, shumica e tyre imituan sjelljet agresive të të rriturve të filmit. Ata mësuan të ishin agresiv duke vëzhguar të tjerët.

Kohët e fundit Berkowitz (1984) propozoi teorinë kognitive-neosocioniste të agresivitetit, e cila e shikon atë si një reagim ndaj ngjarjeve të pakëndshme. Në thelb, kjo teori thotë se kur njerëzit përjetojnë ngjarje të pakëndshme, ata përjetojnë gjithashtu gjendje emocionale negative (ndjenjat e pakëndshme të zemërimit dhe të irritimit). Kjo gjë bën që njerëzit të bëhen agresiv ose t' shmangen ngjarjeve të tilla.

Agresiviteti është një problem shumë serioz jo vetëm për çiftin martesor por edhe për qeniet njerëzore. Çifti martesor duhet të vetëdijesohet si dhe të punojnë për pakësimin e tij në gjirin martesor. Baron (1983) sugjeron disa teknika për të kontrolluar agresivitetin njerëzor. Ndër to janë ndëshkimi, ekspozimi ndaj modeleve jo agresive dhe përvetësimi i shprehive sociale.

Psikologjia e mjedisit janë të interesuar të zbulojnë sesi ndikon mjedisi te sjellja njerëzore, në rastin tonë në çiftin martesor.

Çifti martesor si dhe njerëzit e rrethojnë veten me një “flluskë” të hapësirës personale që ata e konsiderojnë të tyre dhe kanë prirje të stresohen, kur njerëz të tjerë shkelin brenda “flluskës” së tyre. Hapësira jonë personale na mbron nga ndonjë eksitim tepër i madh dhe na ndihmon të ndjehemi rehat kur komunikojmë me njerëz të tjerë, posaçërisht vlen për çiftet martesore.

Psikologjia e mjedisit i njeh katër distanca ndër personale që janë të rëndësishme jo vetëm për çiftin martesor por për ndërveprimet tona sociale: intime, personale, sociale dhe publike.

a) Distanca intime është nga 0 deri në 45 cm. Pamja është minimale dhe ne mbështetemi te ndijimet tona të nuhatjes dhe të të prekurit. Kjo distancë është ajo fushë ku çifti martesor bënë

dashuri ose rehatimi i dikujt në aktivitetin intime, zakonisht të kufizuar në takimet private që mund të kryhen rehat në distanca intime. Ne kemi tendencë që të mos u afrohem kaq shumë njerëzve me të cilët nuk kemi intimitet dhe përpiqemi t'u largohemi në rast se ndodhemi aq afër.

b) Distanca personale është nga 45 cm në rreth 1.2 m. Në këtë distancë prekja është minimale (ndoshta me përjashtim të rastit, kur i shtrëngojmë dorën dikujt), dhe pamja e dëgjimi marrin rëndësi. Kjo është distanca që përdorim për të ndërvepruar me shokët. Brenda kësaj rrekjes mund të kryhen me lehtësi bisedat normale. Ne mund t'i lejojmë të panjohurit në kufijtë e jashtëm, por ua rezervojmë kufijtë e brendshme vetëm shokëve, miqve, të afërmeve tanë.

c) Distanca sociale shtrihet nga afërsisht 1.2 m deri më 3.6 m, dhe përshin hapësirën e kërkuar për ndërveprime sociale më zyrtare. Dëgjimi dhe shikimi janë ndijimet kryesore që marrin pjesë. Distanca sociale përdoret shpesh në biznes, p.sh., gjatë intervistimit të kandidatëve të rinj për punësim ose gjatë bisedimeve për ngritje page.

d) Distanca publike përfshin distanca më të mëdha se 3.6m.

Shkelja e hapësirës personale është atëherë kur uleni me një shok ose shoqe të të njëjtit seks, dhe kini prirje të uleni në krah apo përballë atij ose asaj? Kërkimet kanë treguar se ka ndryshime sipas seksit në parapëlqimin e pozicionit të uljes, gjë që e çon konceptin e distancës ndër personale një hap më tej. Si fjala vjen, burrat parapëlqejnë të ulen përballë dikujt që pëlqejnë, ndërsa femrat parapëlqejnë të ulen në krah. Ndërsa meshkujt shqetësohen më shumë nga shkelje përballë e hapësirës së tyre, ndërsa femrat nuk pëlqejnë kur kjo gjë bëhet nga anash hapësirës së tyre personale. Për shembull, një testim tregon se meshkujt ishin shqetësuar më shumë prej shkeljeve përballë tavolinës, ndërsa femrat ishin shqetësuar më shumë prej shkeljeve të bëra në të njëjtën anë të tavolinës. Përkatesisht burrat kanë prirje ta “mbrojnë” hapësirën përballë tyre në tavolinën e bibliotekës duke vendosur librat mbi të, ndërsa femrat i vendosin librat në krah për të bllokuar zonën prej nga ato kanë frikë se do të vijnë “inkursionet”.

Të kuptuarit e hapësirës personale mund të zbatohet në situata praktike. Për shembull, në rast se ne e kuptojmë se cila është distanca “e pranueshme” ose “e përshtatshme” nga dikush në një situatë të dhënë, mund të komunikojmë më me efektivitet me atë person. Kur e takojmë dikë për herë të parë, duhet të kemi kujdes që të mos i



afrohemi shumë (distanca intime), por gjithashtu nuk duhet t'i rrimë shumë larg (distanca publike) dhe nuk duhet të ulemi përballë një burri. Është gjithashtu e rëndësishme që të mbajmë parasysh ndryshimet kulturore që ekzistojnë.

Nganjëherë nuk kemi mundësi ta rregullojmë hapësirën personale sipas dëshirës. Kur shumë njerëz zënë shumë pak hapësirë, përjetojnë ngjeshjen. Ndeshja nuk është asgjë tjetër përveç ndjenja psikologjike e të mos pasurit hapësirë të mjaftueshme në dispozicion.

Shumica e njerëzve mendojnë pa një pikë dyshimit se, ngjeshja është diçka e keqe. Zakonisht supozohet se ngjeshja e popullsisë çon automatikisht në agresivitet, dhunë dhe krim. Sipas Jonatha Freedman ngjeshja nuk është as e mirë as e keqe. Në vend të kësaj, ai sugjeron se, kur rritet dendësia, rritet intensiteti i humorit dhe sjelljes sonë.

Kështu, në rast se presim t'ia kalojmë mirë në një mbrëmje argëtimi dhe në të ka ngjeshje, vërtet që do të kënaqemi. Por në rast se presim t'ia kalojmë keq, ngjeshja na bën të ndjehemi të mjeruar.

Së fundit mund ta përmendim edhe zhurmë si një gjendje stresuese, që nuk është asgjë tjetër përveç një dukuri psikologjike, por ekspozimi i vazhdueshëm ndaj zhurmës stresuese, siç mund të jetë ajo e një rruge plot trafik, ose e një aeroporti që ndodhët aty afër, mund të ndikojë në mënyrë të padëshiruar te sjelljet e çiftit martesor. Sepse zhurma jo vetëm se mund të çojë në dëmtimin e dëgjimit, mangësi në të lexuar por edhe një pakësim të sjelljeve ndihmuese ndaj të tjerëve ose krijon

ambientin e ferrit, të konfliktit të përhershëm në mesin e partnerëve.

Për Grekët e vjetër dashuria i ka patur dy kuptime: agape dhe eros!

Dashuria është aq e madhe dhe e thellë për të mundur ndonjëherë të kuptohet, të matet apo të kufizohet me fjalë.

Në përpjekje që t'i gjendet shpjegimi, ajo është ndarë në kategori të ndryshme si psh. Dashuri e përsosur, dhe ajo e pa përsosur etj.

Për Grekët e vjetër dashuria i ka patur dy kuptime: agape dhe eros. Kuptimi i parë ka paraqitur dashurinë e lartësuar, dashurinë e pastër e të pakushtëzuar e cila i përshkruhet Zotit, ndërsa kuptimi i dytë ka të bëjë në tërheqjen e thjeshtë trupore dhe me kënaqësitë në joshjet e saj. Çka do qoftë ajo, të gjithë dëshirojmë që të jenë të dashuruar nga të tjerët. Por, së pari duhet që veten ta bëjmë të vlefshëm për dashuri.

Siç pohon Shën Pali: "Dashuria është zemërgjerë, është e dhimbshme, nuk ka smirë, nuk mbahet në të madh, nuk krenohet, nuk është e panjërëzishme, nuk kërkon interesin e vet, nuk hidhërohet, nuk e mban mend të keqen, nuk i kënaqet padrejtësisë, por i gëzohet të vërtetës.

Arsyeton gjithçka, shpreson gjithçka, duron gjithçka. Dashuria nuk mbaron askurrë. (1 Kor 13,4-8)

Gjuha e zemrës është e vetmja rrugë që mund ta zgjidhin krizën e sotme të bashkësisë martesore.

Moter Marjeta GJOKA

**BESIMI, VARFËRIA-PËRVUJTËRIA, HESHTJA MEDITUESE,
- VIRTYTE TË ZOJËS SË BEKUAR!**

«E lumja ti që besove se do të plotësohet çka të qe thënë prej Zotit!» (Lk 1, 45)

Për të folur mbi figurën e Virgjëres Mari model virtytesh, mjafton ti referohemi Shkrimit Shenjtë dhe koncilin II ekumenik të Vatikanit, ku në kapitullin e VIII të kushtetutës Drita e Popujve, na paraqet Virgjëren Mari, Nëna e Hyjit, në misterin e Krishtit dhe të Kishës, dhe besimtarët në soditjen e dashur të Marisë, vërtet shembull i shquar shenjtërie dhe i virtyteve ungjillore, nga e cila rrjedh një ngjashmëri e madhe me Krishtin.

Ndërsa Kisha tashmë e ka arritur në Virgjëren e lume atë përsosmëri e cila e bën të panjollë dhe të parrudhë (Krh. Ef 5, 27), besimtarët e Krishtit përpiqen ende të rriten në shenjtëri për fitoren mbi mëkatit; për këtë arsye i ngrenë sytë nga Maria, e cila ndrit si model i virtytit përpara gjithë bashkësisë së të zgjedhurve. Kisha, duke menduar me përshpirtëri Marinë, të cilën e sodit në dritën e Fjalës së bërë njeri, me nderim dëpërton më thellësisht në misterin shumë të lartë të Mishërimit dhe i përngjason gjithnjë e më shumë Dhëndrit të vet.

E gjithë kjo mundët të jetë e vlefshme dhe frutdhënëse për gjithësecilin prej nesh, po ashtu edhe për shoqërinë tonë, ku në figurën e Marisë shkëlqejnë shumë virtyte, por ne po nënvizojmë tre prej tyre që mundemi ti quajmë qëndrime themelore, të cilët janë: Varfëria aria-përvujtëria, besimi, heshtja medituese.

**Në shkollën e Marisë mësojmë “Varfërinë”
*tapeînōsis***

Koncili II i Vatikanit vazhdon duke e vënë në dukje dhe duke e theksuar që Maria «është e para ndër ata njerëz të përvuajtur dhe ata të varfër të Zotit që me besim presin dhe marrin prej Tij shpëtimin».

Nën atributin e të varfërve të Zotit, një grup qëndrimesh shpirtërore tregohet në Marinë, ku Papa Gjon Pali i II në enciklikën *Redemptoris Mater* (Nëna e shpëtimarit) shprehet kështu: «Maria është thellësisht e përshkuar me frymën e të varfërve të Zotit, që në lutjen e psalmeve, të varfërit prisnin shpëtimin e tyre nga Zoti, duke e vendosur të gjithë besimin tek Ai (Ps 25; 31; 35; 55).

Në të vërtetë, ajo shpall ardhjen e misterit të shpëtimit, ardhjen e Mesisë që ishte, «Mesia i të varfërve (Krh. Is 11, 4; 61, 1)». Është e dukshme në Bibël sesi zhvillohet itinerari i konceptit të varfërisë. Në të vërtetë ka disa interpretime domethënies e varfërisë në Shkrimin Shenjtë, si



fillim, varfëria konsiderohet nga profetët si një e keqe shoqërore në kontrast me planin e Hyjit (Krh. Is 1, 10-20; 29, 13 - 14; Oz 6, 6; Mik 6, 5-8; Zak 7, 4 - 6). Zbulohet që në kundërshtim me të pasurit, të cilët ishin krenarë dhe të padrejtë, të sigurtë për pasurinë dhe fuqinë e tyre shtypëse. Të varfëritë ishin ato të cilët ndiheshin të shtypur, të nëpërkëmbur, të cilët nuk kishin asgjë dhe çdo gjë e prisnin që tu jepej nga Zoti- Jahve.

Në këtë rast na intereson të dimë mbi varfërinë - përvujtërinë (*tapeînōsis*) që i referohet Marisë, fjalëve të saja që ajo shpreh kanë një kuptim shumë të rëndësishëm dhe të thellë, me një domethënie kuptimplotë, dhe tek ungjilli i Lukës i gjejmë këto fjalë: «sepse shikoi me pëlqim mbi shërbëtoren e vet të përvujtë» (Lk 1, 48).

Ajo manifeston një status të sajë të përvujtërisë, dhe një qëndrim të brendshëm ku e bën pjesë e të varfërve të Jahve.

Maria grua e varfër që jeton në pritje, dhe e mirëpret dhuratën e Hyjit «shpëtimarit» të saj, dhe mirëpritjen e bën nëpërmjet Fesë, ajo besohet krejtësisht.

Sot varfërinë është gjithnjë e më e nevojshme ta kuptojmë si një qëndrim shpirtëror i hapjes ndaj zbulesës transhendente dhe biblike, e cila na përfshin në logjikën Hyjnore, shumë më e lartë se dituria njerëzore.

Jetojmë në një shoqëri ku termi varfëri-përvujtëri nuk kuptohet, sepse njerëzit dhe shoqëria që na rrethon ndihen të pasur me dijen e tyre njerëzore, duke harruar se çdo gjë që e kemi është dhuratë nga Hyji. Jetojmë në një shoqëri ku figura e Marisë është shndërruar vetëm thjesht në një devotshmëri të shekullarizuar. Duke harruar se Maria ka një rol shumë të rëndësishëm në historinë e shpëtimit ku mundemi të mësojmë nga kjo e re e Nazaretit varfërinë - përvujtërinë e mbi të gjitha besimin në Hyjin dhe heshtjen meditative.

Pikërisht për shkak të kësaj gjendjeje të përlur, Maria konkretisht ilustron zgjedhjen e saj të lirë Hyjnore të të varfërve dhe të dobëtëve, dhe Shën Jakobi na bën të kuptojmë, duke u shprehur kështu: «A nuk i zgjodhi Hyji ata që për sy të botës janë skamnorë për t'i bërë të pasur në fe dhe trashëgimtarë të Mbretërisë që ua ka premtuar atyre që e duan?» (Jak 2, 5). Në këtë pjesë siç vihet re theksohet edhe «paradoksi i shpëtimit» (Krh Ur 5,2), sipas të cilit «Hyji zgjodhi të marrët në sy të botës për t'i turpëruar të mençurit dhe të dobët në sy të botës i zgjodhi Hyji, për t'i turpëruar të fortit; dhe jo bujarët e botës e të përbuzurit i zgjodhi Hyji, mu edhe ata që nuk janë, që t'i asgjësojë ata që janë» (1 Kor 1, 27-28).

Veprimi i mënjëhershëm i Hyjit konsiston, se Ai përpiket ta çlirojë njeriun nga vetë-mjaftueshmëria dhe krenaria që e bëjnë atë të papërshtatshëm për të bashkëpunuar me Të. Nga e kundërta e Marisë e cila tha: «Unë jam shërbëtorja e Zotit: më ndodhte siç the ti!» (Lk 1, 38) dhe falë kësaj përgjigjeje ajo shprehë gatishmërinë që të bashkëpunojë me Hyjin, duke kaluar nga parëndësia e saj në një mision shpëtimtar. Në Marinë, që ishte një grua e varfër dhe e thjeshtë, Hyji bëri ndërhyrjen përfundimtare të shpëtimit: që ishte «mishërimi». Të gjithë këtë veprim Hyji e bëri duke respektuar krijesën që Ai ka krijuar, në veçanti duke respektuar lirinë e qenies njerëzore. Ishte kështu që veproi Hyji me Marinë, kur i flet nëpërmjet engjëllit Gabriel, Ai e trajton Marinë si një person i lirë dhe i përgjegjshëm. Duke i kërkuar asaj që të përmbahet në propozimin e Tij. Maria e dëgjon, reflekton, dhe i kërkon dritë, në fund pajtohet me lajmin e dhënë nga engjëlli (Krh. Lk 1, 26-38).

Siç vihet re Maria është gruaja që ka hyrë në dialog me Hyjin, që ka pranuar të kryej vullnetin e Hyjit dhe përgjigja e saj ka qenë aktive dhe e përgjegjshme, ajo bëhet imazh i gjallë dhe prototip i

rolit njerëzor në historinë e shpëtimit. Me pak fjalë Maria na manifeston antropologjinë teologjike që rrjedh nga e gjithë Bibla, njeriu nën impulsin e thirrjes dhe hirit të Hyjit, përgjigjet lirshëm me bindjen e besimit.

Në figurën e Marisë mësojmë si të besohemi

Elizabeta, «plot me Shpirt Shenjt» (Lk 1, 41-45), duke iu referuar Marisë ajo shpall me «zë të lartë» *kraughëmegále*: «E lumja ti që besove se do të plotësohet çka të qe thënë prej Zotit» (Lk 1, 45). Askush nuk mundet ta lërë në heshtje lumturinë që shprehi Elizabeta, dhe që përbën të vërtetën parësore mbi Marinë. Në të vërtetë edhe Papa Gjon Palit II shprehet duke thënë, që në shprehjen e Elizabetës «“E lumja ti që besove” mundemi të gjejmë pothuajse një çelës që na hap realitetin intim të Marisë», e mbi të gjitha zbulon një përmbajtje thelbësore Mariologjike, domethënë të vërtetën mbi Marinë, që bëhet realisht e pranishme në misterin e Krishtit pikërisht sepse ka besuar.

Ne nuk mund ta nënvlerësojmë besimin e Marisë, e cila qëndron në kontrast me mosbesimin e Zakarisë dhe në analogji me Abrahamin, dhe ndryshon thellësisht në amësinë e saj, duke e çliruar atë nga një vizion unikal biologjik dhe duke e bërë atë një realitet të mirëpritur personalisht:

Lumturimi përfundues[...] nënvizon në një mënyrë unike besimin e Marisë. Maria, Nëna e besimit, ajo u bë edhe Nënë e Mesisë nga ana trupore. Këtu amësia e Marisë është kuptuar tashmë në terma shumë të thellë; nuk ishte vetëm një amësi fizike, por një amësi eminente dhe shpirtërore, siç duhet interpretuar duke mbajtur në mend rreshtin (38) të ungjillit të Lukës: Amësia e Marisë kishte hapësira të thella në jetën e saj personale, ajo tashmë ishte në gatishmëri me plot besim.

Çfarë përfaqëson ky virtyt për Marinë, na e zbulon vetë Papa Gjon Pali II, i cili na ofron tre kuptime ose përmbajtje besimi.

Besim – dhurim, do të thotë që e vendosë tërë qenien e saj në dispozicionin e Hyjit (Lc 1, 38), braktiset ndaj Zotit pa u rezervuar dhe e kushton vetveten ndaj Tij.

Hyrje në besim, në misterin që është konstant dhe përparimtar në kontakt me misterin e Hyjit.

Besim – shtegtim, domethënë një rrugë e vështirë që Maria e ka përjetuar, sepse në këtë shtegtim ajo është gjendur në një «lodhje të veçantë të zemrës» dhe në «errësirën e besimit», madje gjendet përballë një *kénosi* të thellë besimi në historinë e njerëzimit, në veçanti kur merr pjesë në përvojën tragjike të Golgotës.

Besimi i saj ishte besim si i Abrahamit duke «shpresuar kundër çdo shprese», kështu që në



këmbët e kryqit u bë heroike. Tani besimi përmban një aspekt ndriçues pasi është edhe njohuri për të vërtetën (Krh. 1 Tim 2, 4; 2 Tim 3, 7), ajo ndryshon nga vizioni përfundimtar dhe mban një karakter enigmatik: «Vërtet, tani shikojmë si në pasqyrë e në mënyrë të errët, por atëherë do të shohim faqe – faqas» (1 Kor 13, 12). Kjo vlen edhe për Marinë që nuk i kuptoi fjalët e birit të saj dhe u gjend në vështirësi dhe kontradikta. Mundet të supozohet tek ajo një përvojë e quajtur kontakt mistik, që zhytet në misterin e pranisë Hyjnore dhe injekton ndriçime të veçanta mbi identitetin dhe misionin e saj. Lumturit e Marisë burojnë nga një mundësi themelore, për fjalën e Hyjit dhe për Jezusin, Birin e Tejetlartit i cili u bë i pranishëm në botë, në një kulturë si ajo post-moderne e karakterizuar nga mendimi i dobët dhe shoqëria jo e duhur, për këtë mundemi të themi që është edhe refraktare ndaj referencave të forta, diskutimi mbi Marinë bëhet veçanërisht sugjerues dhe i artikuluar, duke rizbuluar në të një mësuese vlerash, dhe ku gjithë ato të cilët kanë humbur vlerat e vërteta të jetës mund ti ri gjejnë në figurën e Marisë, e cila ishte një qenje njerëzore si gjithë ne, dhe duke e vendosur vullnetin e saj në vullnetin e Hyjit u besua totalisht duke bashkëpunuar me planin e Tij, u bë Nëna e gjithë njerëzimit.

Në shkollën e Marisë mësojmë heshtjen meditative

Luka me aftësinë e tij mjeshtërore na e paraqet Marinë si një ikonë heshtje dhe lutje.

Në të vërtetë pas lindjes së Jezusit dhe gjetjes së tij në tempull, Nëna e tij, «Maria i mbante mend me kujdes të gjitha këto ngjarje dhe i shoshiste në

zemrën e vet» (Lk 2, 19; Krh. Lk 2, 51). Kjo sjellje është qëndrimi i të diturit, dhe pikërisht këtë veprim shpirtëror dhe të dyfishtë e gjejmë në figurën e Marisë. E cila ruan dhe reflekton në mënyrë aktive, me ushtrimin e kujtesës në zemër, domethënë në bërthamën e brendshme dhe qendrore të personit të saj, fjalë dhe ngjarje në lidhje me Krishtin. Meditonte, që do të thotë krahasimi i elementeve të ndryshëm dhe interpretimi i tyre. Është qëndrimi i njeriut të ditur që mediton mbi mësimet e ligjit për të hyrë në logjikën e Hyjit dhe për ta zbatuar fjalën e Tij nëpërmjet veprave (Krh Sir 50, 27-29).

Përmes kujtesës dhe krahasimit, Maria kryen një veprimtari hermeneutike me prirjen për të identifikuar sensin e duhur të një ngjarje, që gjindet përpara një situatë që ngjall çudi dhe nuk është kuptimplotë. Pikërisht ky është shembulli që na është ofruar nga Maria e Nazaretit e cila e mikëpret me besim zbulimin Hyjnor dhe detyrën e saj historike – shpëtimtare, e pastaj mediton në zemrën e saj dhe kërkon të kuptojë misterin e Hyjit. Sipas Dupuy shprehet që Kardinal Pierre de Bérulle ka cituar se e gjithë kjo zhvillohet në heshtje të artikuluar, dhe në heshtje adhurimi, heshtje dëgjimi dhe heshtje transformimit.

Maria shfaqet si gruaja e ditur që kujton, aktualizon, interpreton dhe krahason fjalë dhe vepra; [...] e cila pyet veten mbi domethënien dhe kuptimin e fjalëve që i duken të errëta, mbi të cilat është projektuar hija e kryqit (Krh Lk 2, 34-35; 48-50) dhe e mikëpret heshtjen e Zotit me lutje dhe në qetësi.

GIOVANNI CUCCI S.I

MELANKOLITË E REJA

Fatet dhe dëshirat sipas Massimo Recalati

Termi “melakonik” dhe “melankoli” trajtohen shpesh herë si sinonime edhe pse sipas aspektit psikologjik ato i referohen statuseve të ndryshme. Melankonizmi është një gjendje e shpirtit, një gjendje trishtimi dhe mërzi të qelqit që lidhet me situata të përpikta. Melankolia tregon një gjendje patologjike, një ulje të madhe të humorit, afër depresionit, që mund të bëhet kronike, deri në psikozë. Jo vetëm në aspektin gjuhësor, por edhe në literaturën psikologjike, këto terma rezultojnë të këmbyeshme me njëra-tjetrën.

Dimensioni historik dhe kulturor i natyrës psikologjike

Duke studiuar këtë tematikë, të bie në sy se si trishtimi introspektiv “e keqja në të jetuar”, u bë protagoniste në imagjinatën perëndimore, duke filluar nga epoka romantike, deri në fillimin e simbolizmit, duke iu referuar sjelljes njerëzore. Referimet për këtë që sapo thamë janë të panumërta dhe shtrihen në të gjitha shtresat kulturore: të artit, të letërsisë, të filozofisë dhe psikologjisë, të shekujve të fundit.

Disa kanë pyetur veten përse melankolia shfaqet në një mënyrë kaq dominuese duke filluar nga kjo periudhë: duke kërkuar një lidhje të mundshme mes gjendjes psikologjike dhe situatës historike; duke dhënë hipoteza, për shembull: një rrjedhë e tillë e papritur e palumturisë është rrjedhim e zhgënjimit prej premtimeve të paralizuar të iluminizmit dhe të revolucionarëve nacional të epokës së Napoleonit. Cilado qoftë hipoteza më e akredituar, qëndron fakti që shqetësimet psikologjike, si çdo karakteristikë njerëzore, rezultojnë që si nga ana historike dhe politike të jenë të njohura. Një libër i fundit i Massimo Recalcati kërkon të tregojë se si dimensionet psikopatologjike mund të gjejnë një fushë të përshtatshme të letërsisë, referuar klimës historike-politike, në të cilën manifestohet.

Frojd kishte vënë re lidhjen mes përhapjes së histerizmit e të nevrizmit obsesiv dhe të karakteristikave viktoriane të kohës së tij. Më pas, të tjerë autorë kanë treguar se si periudha e shekullit të pas luftës, u karakterizua nga mirëqenia e sjelljes së një numri gjithnjë e më të madh të personave të spektaklit. Bordieu, vëren se si lulëzon narcizizmi, e pastaj përballë zhgënjimeve të pashmangshme, ai kalon në depresion dhe tërheqje artistike, duke ia mbathur përgjegjësi të veta, si një njeri i madh. Në kohën e saj, klima e Luftës së Ftohtë, është terrori i një konflikti nuklear që ka parë rritjen e përhapjes së shqetësimeve të personalitetit, si paranoja dhe fobia, të shprehur edhe në zgjedhjet e sakta ekonomike dhe shoqërore (të mendohet për përhapjen në Zvicër të strehimeve antiatomike, të bëra gati një mburojë e domosdoshme në ndërtimin e

shtëpive të viteve '60 dhe '70, në një shpërndarje bashkëkohore të bunkjerëve në Shqipëri, në kohën e Enver Hoxhës, apo terrorit të të qenit nën vëzhgim nga regjimi politik. Pas rënies së Murit të Berlinit, simbolizmi i lënë në harresë nga ideologjia, shikon rritjen e histerisë kolektive dhe frikës ndaj së panjohurës. Për të kaluar këtë ndjenjë e pasigurisë, sigurisht që ndikon kriza ekonomike dhe papunësia, që i ka fillimet në 2008 dhe tani është e vështirë që të shihet një rrugëdalje e mundshme.

Melankolikë e reja

Rrjedhin kështu edhe modalitetet e reja të përhatisë. Për Recalcati, dy eventet në veçanti shënojnë një ndryshim të panoramës aktuale psikike. Të dy kanë në qendër fshirjen e figurës së atit (veçanërisht funksionit të tij për të bashkuar dhe së dyti në kuptimin e ekzistencës) të mënyrës psikike të subjektit; një fshirje që Recalcati quan “Forclusion”, duke e marrë si term nga Lakani.

Një nga vijueshmëritë më të përshtatshme të forlusionit, është që ta bëjë të pamundur përpunimin e zisë, pra, për të shtuar mungesën, duke e prezantuar para së gjithash në nivelin simbolik, pasi mungon gjuha, e rrjedhimisht, distanca nga të jetuarit. Kjo është thelbësore për të përpunuar humbjen, pra për të ridhënë një kuptim të mundshëm, një dëshirë për të jetuar ndryshe: “Jeta njerëzore nuk është vetëm gëzim, nxitim vital, hapje, pasi ajo nuk mund ta evitojë dhimbjen e mungesës dhe të humbjes. Jo më pak, kjo humbje është edhe kushti i rrjedhjes së vetë jetës dhe të shtysës së vet të dëshirueshme, të ekzistencës së vet, të të jetuarit jashtë vetvetes, e ekspozuar ndaj mundësive vitale.”

Shoqëria aktuale karakterizohet nga atrofia e dëshirës, që ka ardhur si rezultat i mungesës së transmetimit të pasurisë për të ndërtuar identitetin dhe dimensionin e projektimit në jetë. Shqetësimet e reja janë vijimi i një vetmie dëshpëruese, ku fëmija ka marrë gjëra, por nuk është edukuar për të dëshiruar; e jeta ka zbehur kuptimin e saj, dimensionin e saj projektues për të kapur çastin. Në këtë mënyrë formohet epshi absolut, kërkimi i shfrenuar i lumturisë dhe perversioni si tentativë për ta paralizuar dhimbjen e të jetuarit.

Klinika e “Pasionëve të trishtueshme”, e trajtuar në një libër të suksesshëm të Miguel Benasayag edhe Gerard Schmit (një filozof dhe psikiatër), si rezultat i rritjes shqetësuese të kërkesave për ndihmë psikologjike nga ana e të rinjve dhe të rejave franceze, por jo vetëm, është një tjetër tregues për këtë fragment. “Pasionet e trishtueshme”, siç i quante Spinoza, janë tregues i një dhimbjeje të madhe të brendshme, të një përhatisje ekzistenciale, që në ndryshim ndaj dhimbjes, mungon për një arsye të saktë apo të një objekti referues. Këto

janë protesta psikike përballë mungesës së kuptimit të të ekzistuarit. Për këtë, sipas dy autorëve, “krizat aktuale” është diçka e ndryshme nga të tjerat...”, bëhet fjalë për një krizë thelbësore të jetës sonë. Duket që jeta jonë nuk mundet më që të ketë luksin, për të shpresuar apo për t’i propozuar të rinjve integrimin e tyre social, si fryt i një dëshire të pafundmi.

E kështu, në vend të dëshirës së pafundme (asnjëherë e eksploruar me të vërtetë), e cila ka të bëjë me një mungesë, (de-sidus), ajo merr përsipër prezencën e vazhdueshme të objektit, është ngulmuese, e brendshme, që nuk të jep kënaqësi e që e bën subjektin të humbë në vetë të jetuarit deri sa mbytet. Vetë të jetuarit bëhet kështu sëmundje, goditje ontologjike, e lidhur me vetë faktin për të jetuar një jetë pa kuptim.

Zgjidhja politike e rasteve klinike të reja

Melankolikë e reja kanë mbi të gjitha rënie politike. Ky është aspekti më interesant i të mençurit Recalciti, i cili përgënjeshtroi idenë e psikoanalizës si një praktikë që i gjuhëzohet problematikave të individit, në dëm të hapësirës së tij shoqërore dhe publike. Libri i dedikon shumë faqe në lidhje me shqetësimet psikologjike dhe diktaturave totalitare. Liderët që e kanë realizuar, veçanërisht Hitleri, Stalini, Musolini, qenë të karakterizuar ndaj mohimit të baballarëve, të dëlirëve paranojakë, duke menduar se ishin mishërimi i një misioni të ardhur nga lart, ose ndaj të cilit duhet luftuar, deri në shkatërrimin e tij e të vetë kombit. Por ato patën mundësi të shijojnë një aprovim të padiskutueshëm, pasi kanë ofruar siguri, stabilitet, në dëm të kompleksitetit dhe ndryshimit.

Mirëkuptimi unanim në lidhje me to gjen në motivimet, edhe psikologjike: situatën e madhe të pasigurisë dhe paafësisë për të shpjeguar mungesën, bëjnë shumëkënd që të mundin lirinë me mundësinë. Liria na kujton rrezikun dhe marramendjen e zgjedhjes edhe kaosit në të cilin mund të shembet kur mungon një dëshirë që mund të sjellë bashkim dhe dinamizëm ekzistencës.

Recalti flet në lidhje me këtë gjë, si një censurë e dëshirës dhe që shtyn drejt mizantropisë, lidhur me njerëzit që nuk i takojnë të njëjtave kategori. Fashizmi është një reversion i dëshirës që, e privuar nga edukimi i saj, nuk mundi që t’ua trashëgonte brezave të ardhshëm. Nuk është vetëm një fryt frike, por është edhe një zgjedhje: “Skandali i vërtetë konsiston në faktin që masave u është dashur të dëshirojnë fashizmin, që ka ekzistuar dëshira e nënshtrimit.” Në këto raste domosdoshmëria për mbrojtje bëhet një pulsiv vdekjeje. Nuk është rasti, si me të drejtë ka nënvizuar Umberto Eko “Apeli i parë i një lëvizjeje fashiste është gjithnjë kundër të padëshirueshmëve.”

Perversioni psikologjik tregohet edhe në rritjen e numrit të hermetikëve, në veri të botës, për t’u mbrojtur nga kërcënimi i tjetrit. Në emër të lirisë absolute privohen të tjerët. “Theksi pubertal i lirisë i ka lënë vendin atij hipernormativ dhe në fund atij racial. Paradigma është e sjellë mbi vetveten: liria absolute

hidhet drejt burgosjes absolute.

Një tjetër formë e mbylljes, jo e re në të vërtetë, është ajo që i është propozuar shoqërisë konsumatore: akumulimi dhe lavdia e fuqisë, që përkthehen në dorështërngimin në fyt, në luks, në lojërat me shaka të atij që nuk e merr seriozisht tjetrin dhe tallet me të. Forma të vetëkënaqësisë patologjike, si në figurat melankolike të sipërpërmendura që refuzojnë i jetën: “Koprracia transformon jetën e vet në jetën e një të vdekuri”. Nuk është e thënë ama që koprracia rritet vetëtiu nga kalimi i viteve. Sa më shumë që rrëshqasim drejt vdekjes, aq më shumë koprracia përpiket që t’i ngjitet gjithçkaje që ka”. Akumulimi këtu është parë si mbrojtje e shpërbërjes dhe bashkë me të si një shenjë e dukshme e progresionit pushtues.

A është e mundur që ta zbusim melankolinë?

Libri i Recalciti e ka meritën se trajtoi tematika që nga aspekti i përkufizimit i shpëtojnë një trajtimi sistematik, por që mund të ndihmojnë që të lexojnë probleme shumë aktuale dhe për të treguar vlerën e të mësuarit edhe në aspektin historik e politik. Megjithatë, melankolia mbyll në vetvete edhe një mundësi shlyerjeje. Ato që e njohin dhe janë të disponuar për ta dëgjuar mund të gjejnë në të një mësim të mençur dhe projektues.

Kjo ishte edhe jeta e projektuar nga refleksioni i kësaj të keqeje të të jetuarit që nga rrjedhja e tij. Aristoteli duke iu referuar analizave mjekësore të Hipokratit, nuk shikon aspak melankolinë, por vetëm një trashëgim negativ të një karakteri të trishtuar dhe introvert: ai kërkon që një gjendje e tillë shpirtërore është fryt i një vlerësimi të situatës aktuale, që nuk mund t’i japin fund dëshirave të thella. Me fjalë të tjera, melankoliku është një person i cili nuk kënaqet me gjendjen e përditshme, por kërkon më shumë dhe nëse i kushton rëndësi këtyre pakënaqësive ai mund të shprehë më të mirën e tij dhe të nderë trishtimin aktual, në ndryshim nga sipërfaqësorja e optimistit.

Stagiriti njeh prezencën e këtij trakti, te pjesa më e madhe e heronjve dhe gjenive të kohës së tij (Lisadri, Empedokle, Sokrati, Platoni) dhe pyet me habi: “Cila është arsyeja që burrat e jashtëzakonshëm në fushën e filozofisë, politikës, poezisë apo artit, janë melankolik të dukshëm?”

Përse melankolia dhe gjenialiteti janë të lidhura shpesh me njëra-tjetrën? Për Aristotelin, përgjigja lidhet me luhatjet e zemërimit të zi, që e ka origjinën në këtë temperament, që lidhet me thellësinë e shpirtit, ku rezultati mund të jetë gjenialiteti apo çmenduria (një tjetër binom shpesh herë i treguar nga studiuesit) të panjohur për atë që nuk është melankolik. Aristoteli bën një lëvizje të brendshme në analizën e tij: vëren në melankoli aspektin hyjnor, që tregohet në fuqitë më të larta të njeriut, ashtu si gjumi, imagjinata dhe arsyeja. Të gjitha këto janë manifestime të jetës hyjnore. “Pika e nisjes e arsyes, nuk është arsyeja, por diçka më e fuqishme. E kush mund të jetë më e fuqishme se shkenca dhe intelekt, nëse jo Zoti? Andaj janë njerëzit melankolik, te të cilët ëndrrat jenë të vërteta.”

Stadi i pakënaqësisë që e karakterizon melankolikun, e merr dhe e çon në distancat e botës ku jeton e që dëshirojnë të tjerët, duke gjetur rrugë të reja, që mund t'i japin përgjigje pakënaqësive aktuale. Jo rastësisht, gjendja shpirtërore ka karakterizuar dhe misionarët më të mëdhenj. Është interesante që Matteo Ricci, në letrat e tij, thotë që vuan nga një sëmundje e mirë, që mund të shpirtëzojë dëshirën e tij që të hyjë në Pekin, pavarësisht vështirësive e pengesave të hasura që me hyrjen e tij në Kinë. Jezuiti ndalohet më së shumti në sugjerimin e saktë që ka marrë nga Zoti në një ëndërr, i cili e ndihmon që të dalë nga situata e tij: “Ndërsa po rrija në meditim për përfundimin e trishtuar të këtij udhëtimi dhe për pengesat e udhëtimit, ëndërroja të më bënte vizitë një njeri i panjohur... Unë duke u mrekulluar se si ai mundi të hynte në zemrën time (...) i përulëm në këmbët e tij e duke qarë me dëshpërim thashë: “Zot, duke qenë se e dini këtë, përse deri tani nuk më keni ndihmuar?” Atëherë ai më përgjigjet: “Shkoni në atë qytet, - m'u duk se po më tregonte Pekinin, - atje do të të ndihmoj.” Kjo ishte ëndrra. Është domethënëse fakti se, në ndryshim nga shumë shkrime të devotshme dhe të rrepta të kohës së tij, Ricci nuk censurohet, nuk prezantoi një portret hijerëndë dhe të njëtrajtshëm të vetvetes, nuk pati turp që të shfaqej i trishtuar dhe në krizë. Dialogun me këto ndjenja, i hedh në letër dhe mundohet të nxjerrë një mësim prej tyre. Në një tjetër letër të p.Ludovico Maselli, ai pranon që është shumë i ndjeshëm, (flet për një lloj melankolie që më duket se është “e mirë”), madje do të kishte turp, sikur të mos e kishte”. Ricci e lidh melankolinë me ëndrrën dhe imagjinatën (një element themelor për anën shpirtërore injaciane), që inspirojnë ndryshime të rëndësishme për aktivitetin e tij si misionar, si për shembull: të veshësh rroba të ndryshme dhe të ngulmosh në njohje miqësore për të hyrë në Pekin e të pritësh nga perandori. “Duke njohur në mënyrë të qartë dhe pa ndrojtje melankolinë e tij, duke pranuar pa hipokrizi të devotshme njerëzoren e tij, trishtimin e tij, nostalgjitë e tij dhe lotët e tij, Mateo i jep melankolisë kuptimin e tij më të mirë, atë kuptim që hap mundësi të reja dhe ëndrra për t'i realizuar. Natyrisht, këtu nuk ka të bëjë me patologji, por me një hedhje poshtë kulturore të një

gjendjeje të tillë shpirtërore, që hap mundësi të reja.

Mësimi që nxjerrim nga melankolia

Nëse melankolia “e mirë” është një gjykim për të tashmen, që lind nga një pakënaqësi, nuk duhet të heshtim. Ajo ka të bëjë me atë që Recalti quan “të papërmbajtshëm”, që është e përgjegjshme me dëshirën e thellë, që frymon çdo qenie njerëzore dhe që mund të eksplorohej vetëm në lidhje me një tjetër.” Hapësira që kultura njerëzore gjithnjë ju ka njohur, pikërisht sepse zbraz ambientin aseptik, është në gjendje të zbusë melankolinë, duke e mbrojtur nga devijimet, për t'i rikthyer dimensionin e saj në projektimin utopik. Për të eksploruar një dimension të tillë, në pikëvështrimin analitik, si në pjesët e përmendura në pjesën e fundit të librit ose sipas aspektin historik; në aspektin letrar jepet përmes shprehjes simbolike të figurës së Telemakut, - pranon të shohë jo një kërcënim, por mundësinë e vetme të mundshme për të përfunduar dëshirën e vet thelbësore.

Melankolitë e reja e kanë varur dëshirën dhe i kanë lënë rrugë e lirë vdekjes; vetëm në dialektikën e njohur mes dëshirës dhe limitit, është e mundur që të thyejmë burgun autik, që na mbron-burgos dhe bë që ta shohim tjetrin si një kërcënim. Por, për ta bërë këtë, është e nevojshme që të dialogojmë me misterin që e karakterizon njeriun, një mister që ai nuk mund ta zotërojë e që mund të njihet vetëm në raport me tjetrin.

Ky është kurrizi i melankolisë së përshkruar në mënyrë të shkëlqyer nga Romao Guardi: “Melankolia është shqetësimi i njeriut kur vëren ardhjen e të pafundmes. Bekim dhe kërcënim në të njëjtën kohë. Kuptimi i njeriut është në të qenit një kufi i gjallë, për ta marrë mbi supë këtë jetë – kufi dhe ta çojë deri në fund. Me këtë ai po lidhet me realitetin, është i lirë nga mahnitjet me një lidhje false, të menjëhershme me Zotin. Lidhja më njerëzore është ajo e influencuar nga kufiri, i vetmi i përshtatshëm për realitetin”.

Përktheu: Bernardina Shahini

Material i përkthyer nga revista kulturore – fetare “La civiltà cattolica”, 2020.



Federico LOMBARDI

TË VDESËSH NË ZOTIN

Artikulli i pestë i “Ditarit të krizës” shkruar nga atë Lombardi: për Jezusin nuk ka të vdekur të harruar, në asnjë vend të tokës e të historisë, në asnjë skaj të goditur nga pandemia



R. SH. - Vatikan

Një nga mendimet më të mprehta e më të shquara shpirtërore të Shën Gjon Palit II ishte ta mbante gjallë kujtimin e martirëve të shekullit XX, një nga shekujt më të dhunshëm të historisë. E natyrisht, duke kujtuar para Zotit dëshmitarët e shumë të fesë, nisëm të kujtonim, bashkë me ta, edhe viktimat e panumërta e, më gjërë akoma, gratë e burrat e të gjitha racave, kohëve e gjendjeve, që humbën jetën e tyre në rrethana dramatike, në tokë e në det, në luftë e në paqe, larg çdo ngushëllimi njerëzor, viktimat të dhunës pa pikë kuptimi a të katastrofave, të braktisjes a të vetmisë. Të duket sikur dëgjon një britmë zemërcjerrëse dhimbjeje, që ngrihet në heshtje nga pluhuri në të katër anët e dheut; britmë, që dëgjohet nga ata, të cilët kanë veshë për të dëgjuar, britmë, që të kujton miliona e miliarda të harruar. Britmë e krijesave, që e ndjejnë veten të rrokullisur tatëpjetë, në hon e në harresë. Për ta e me ta duam të lartojmë edhe ne sot, një britmë pseje e mëshire!

Pamja e radhës së arkivolave në Kishat e Lombardisë, ata të varrezës së madhe pranë New Yorkut, mendimi se shumë njerëz, posaçërisht pleq vdiqën në kushte izolimi e vetmie të frikshme gjatë muajve të fundit, na prek thellësisht. Jo vetëm për dhimbjen e natyrshme të të afërmeve, që nuk mundën ta jetonin çastin kur të dashurit e tyre duhet të ndaheshin nga jeta me ngushëllimet e krishtera, por më shumë akoma për vetë të vdekurit, për ata, që u shuan e po shuhën në vetmi.

E gjithë kjo, na bëri të kuptojmë edhe një herë sa të çmuara janë afërsia dhe dashuria e singertë në kohë ligështie, pleqërie, sëmundjeje. Por na bëri edhe të mendojmë se ndoshta çdo vdekje, duke përfshirë edhe tonën, mbart gjithnjë me vete përmasën e vetmisë! Jemi vetëm në vdekje! Sepse, në fund të fundit, çdo ngushëllim e afërsi e të tjerëve, është e pafuqishme. E asgjë nuk mund të na shpëtojë nga kalimi përfundimtar.

Si mund të përgatitemi për këtë çast, nga i cili nuk shpëton dot askush? Por që për viktimat e coronavirusit arriti kur nuk e prisnin? Ndonëse e kishin përpara? Si e kemi edhe ne? Si të ikim larg ankthit, që na kujton se mund të rrokullisemi papritmas në honin e asgjësë?

Pak ditë më parë patëm hirin të rijetojmë vdekjen e Jezusit. Çdo ditë e rijetojmë, duke u bashkuar sakramentalisht a shpirtërisht me Jezusin në kungim. Po e Premtja dhe e Shtuna e Madhe sjellin me vete një hir krejt të veçantë. Vdekja e Jezusit, e vërtetë dhe mizore, mbart me vete gjithë përvojën e braktisjes nga ana e njerëzve, e edhe të braktisjes misterioze nga ana e Zotit, siç na e kujton vargu i Psalmi, që i kushtohet Jezusit mbi Kryq. Një vdekje e vërtetë, e pasuar nga varri, ku u mbyll kufoma e Zotit ditën e shtunë. Të Shtunën e Madhe, ne besojmë, e pohojmë: “...u kryqëzua, vdiq e u varros; zbriti në ferr...”. Zbritja e Jezusit në ferr na thotë se ai u bë i afërt me vëllezërit e me të gjithë ata, që zbresin në humnerën e vdekjes. Që nuk e harron askënd! Po për Jezusin nuk ka të vdekur të harruar, në asnjë vend të tokës e të historisë, në asnjë skaj as skutë, të prekur nga pandemia. Jezusi vdiq me të vërtetë, si ata, e me ta!

Pas vdekjes së Jezusit, zbritjes në ferr e ringjalljes, vdekja nuk është më siç ishte. “E ku është, o vdekje, fitorja jote?” - brohoret Shën Pali. Vdekja tani mund të jetohet me Krishtin, që na bind se dashuria e Zotit është shumë më e fortë se vdekja. Se e kapërcen çdo vetmi njerëzore. Njeriu që vdes, edhe më i panjohuri e më i harruari, mund ta lëshojë, kështu, shpirtin në duart e një Ati! ak ditë më parë Françesku, në Shën Martë, duke komentuar fjalët që Jezusi ia tha Nikodemit, i ftoi të gjithë t’ia ngulin sytë kryqit. Është pika qëndrore e fesë dhe e jetës së krishterë. Kush i ka parë, nuk mund t’i harrojë kurrë pamjet e Gjon Palit II, të përqaftuar me kryqin në kapelën e tij, pak ditë para se t’i mbyllte sytë përgjithmonë për dritën e kësaj bote, ndërsa populli ishte mbledhur në Koloseum, në lutje, duke ndjekur Udhën e Kryqit të së Premtes së Madhe. Nuk ka mënyrë tjetër përgatitjeje për ta jetuar vdekjen, pëveçse duke e shikuar me gjithë shpirt Krishtin, që vdes me ne e për ne, e duke dhënë shpirt të përqaftuar me Të me gjithë zemër. Atëhere vdekja, e jetuar me Jezusin, mund ta humbasë fytyrën e saj të llahtarshme e t’ia lërë vendin misterit të dashurisë e të mëshirës. Atëhere, ndoshta, nuk do ta ndjejmë më dëshirën për të mos menduar se ka vdekje, për ta shlyer nga e përditshmja, madje, me fe e me kalimin e kohës, mund të na bëhet familjare deri në atë masë, sa ta quajmë “motër” si e pati quajtur Shën Françesku.

Edhe në botën e shekullarizuar, vdekja vjen se vjen, me koronavirusin a me ndonjë mënyrë tjetër. Por të mos e harrojmë se falë Jezusit, vdekja nuk do ta thotë më fjalën e fundit. Çdo vdekje, edhe më e harruara e më vetmitarja, nuk është rënie në hon, por në duart e Zotit!.

TË DOBËT, POR NË DUART E ZOTIT!

*E kushtuara e Zotit, e cila si infermiere e përjetoj vet koronona virusin do shprehej:
“Kam mësuar braktisjen në duart e Zotit, por kam thëlluar më shumë lidhjen time më të”!*

*Nëse jetojmë, jetojmë për Zotin,
e nëse vdesim, vdesim për Zotin.
(Rom 14, 7^a)*



Në punën time si infermiere në spitalin Rajonal, Shkodër, në bashkëpunim me kolegë tjerë, kemi ndier thirrjen e brendshme që të jemi ato duar të cilët forcojnë shpirtin e botës së shkurajuar, të transmetojmë forcën e shpresës që mund çdo frikë e vuajtje kalimtare.

Ishte e nevojshme të shpresojmë duke rrezikuar në ballë të armikut të pa njohur, “ambasadorit të vdekjes” Covid-19. Një rrezik i cili mund të përmbyste sigurinë e jetës, të krijonte distancë me njëri-tjetrin, të humb orientimi e njerëzve, shpresën për të ardhmen e tyre.

Kjo situatë gjithëpërfshirëse, nxjerri në pah, atë që jemi, të dobët, por në duart e Zotit. Na bëri të njohim zemrën e Atit të mirë, të ndejmë afërsinë e tij, Ai që nuk është larg asnjërit prej nesh. “Sepse në të jetojmë, lëvizim e jemi”, Vap 17, 28.

Koha e pandemisë, ka qenë jo vetëm kohë shqetësimit, ankthit, por kohë hirit, mundësi për të shpresuar, për t'u dhuruar, për të dashur më shumë, kohë mirënjohje Zotit, që na ka dhënë jetën. Ka qenë raste i volitshëm për të çmuar bukurin dhe qëllimin e vërtetë të jetës, “për mua të jetoj është Krishti...”. Fil 1, 21.

Forca e shpresës, e fesë dhe e dashurisë në kohën e pandemisë, më të cilën kam qenë infektuar

personalisht, me ka bërë ndër të tjera të përjetoj një lidhje të fort solidariteti dhe familjaritet me kolegët e mi të prekur nga Covid-19, si dhe me bashkmostrat e mia Stigmatine, të cilat me kanë mbështetur në këtë periudhë delikate. Kam ndier forcën e lutjes dhe interesimin e vazhdueshme të Fretërve minor, meshtarët, mostrat të Kongregatave tjera, për kujdesin dhe mbështetjen e Kishës, sidomos Barinjte e saj të cilët prej zemrës i falënderoj.

“Mos u brengosni për jetën tuaj...” Mt 6, 25. Kam mësuar braktisjen në duart e Zotit, por kam thëlluar më shumë lidhjen time më të. Kam provuar të shikoj përtej shqetësimeve të rëndomta, të shikoj përtej projekteve personale, ku kam kuptuar që jeta nuk varet prej asaj çfarë mund të bëjmë, por në dialog më Hyjin duke pranuar realitetin që jetojmë.

Pas vuajtjes ndodhë fitimi, pas mirësisë gëzimi, gëzim edhe në dobësi, në të cilën bëhet e dukshme një forcë misterioze. Çdo vuajtje, edhe errësira ma e madhe e kryqit, është gjithmonë e mbështjedhën më gëzim, ndoshta jo e ndjerë, por e vërtetuar e njohur në fe.

*Shkodër, 14. 05. 2020
Motër Marjana Ndreca
Motër françeskane Stigmatine*



RËNDËSIA E JETËS DHE E SHËNDETIT
“Por duam gjithashtu të theksojmë se jeta e shëndeti duhet të ruhen”



Deklaratë për shtyp

Të hënë 27 prill, Ipeshkvijtë e Kishës katolike në Shqipëri, me rastin e festës së Zojës së Këshillit të Mirë kanë kremtuar meshën në Shenjtëroren e saj në Shkodër. Më pas u mbledhën në një takim të jashtëzakonshme në Fshatin e Paqes (Shkodër) për të diskutuar rreth situatës së krijuar nga Koronavirusi dhe ecurinë e kësaj situate.

Gjatë mbledhjes u fol rreth disa argumenteve që kanë të bëjnë me çështjet baritore dhe jetën e Kishës katolike, si edhe për disa tema që kanë të bëjnë me gjithë shoqërinë shqiptare, në këtë kohë pandemie. U pa e arsyeshme të bëhen publike disa mendime të kësaj Konference në lidhje me disa nga këto tema, sikurse janë rëndësia e jetës dhe e shëndetit, situata ekonomiko-sociale e familjeve shqiptare dhe ushtrimi i kultit, në këtë kohë pandemie.

Së pari rëndësia e jetës dhe e shëndetit

Kisha katolike, qysh në fillim të periudhës së izolimit, për shkak të pandemisë, e pa të arsyeshme që e mira e jetës dhe e shëndetit të tutëlohet e prandaj u bashkëpunua pa ngurrim me organet përkatëse duke i pezulluar veprimtaritë tona liturgjike dhe baritore.

Në këtë situatë kemi sakrifikuar shumë gjëra për ta mbrojtur jetën njerëzore: shumë vende pune, turizmin, si edhe kremtime fetare. Por duam gjithashtu të theksojmë se jeta e shëndeti duhet të ruhen në të gjitha statet e jetës së njeriut, nga ngjizja deri në vdekje e fatkeqësisht ka edhe “pandemi” që vrasin çdo ditë shumë jetë njerëzish me anë të abortit.

Duke vlerësuar shumë punën e të gjithë atyre që janë të angazhuar në fushën shëndetësore, duhet të konstatojmë se strukturat spitalore në vendin tonë kanë ende nevojë të përmirësohen. Ndaj është detyrë e organeve kompetente të shtojnë kujdesin ndaj këtyre strukturave, sikurse janë spitalet dhe

klinikat e ndryshme në vendin tonë. Jeta dhe shëndeti kanë rëndësinë e tyre jo vetëm në momente të veçanta, sikurse është një pandemi, por gjithmonë dhe për të gjithë njerëzit e të sëmurët. Gjithashtu kujdesi ndaj stafit mjekësor që janë në përballje direkte me sëmundjen dhe tamponet në gjurmimin e sëmundjes do të ishin një vlerë e shtuar në këtë sfidë që po kalon vendi ynë.

Jemi të shqetësuar gjithashtu për *shëndetin psiko-shpirtëror të njerëzve*, të situatës së këtij shëndeti nëpër familje dhe tek individë të të gjitha moshave dhe që është rënduar akoma më shumë për shkak të situatës së krijuar nga izolimi dhe varfëria ekonomike në këtë kohë. Duhet menduar urgjentisht nga ana e të gjithëve për ofrimin e asistencës për këto raste të cilat ka gjasa të shtohen gjithnjë e më shumë, duke prishur kështu ekuilibrat brenda familjeve dhe në shoqëri.

Së dyti situata ekonomiko-sociale e shumë familjeve

Kemi konstatuar gjatë këtyre ditëve, qoftë personalisht e qoftë nëpërmjet operatorëve tanë në terren, se situata ekonomike e shumë familjeve është shumë e rënduar. Sa kemi pasur mundësi, në zonat që mbulojmë, kemi qenë pranë këtyre familjeve, *sidomos atyre me situata më ekstreme*, por e shohim se asistencë nëpërmjet ndihmave nuk është zgjidhje. Pandemia ka thelluar më shumë

varfërinë e familjeve tashmë të varfra e ka krijuar varfëri të reja në pragun e mbijetesës. Kjo punë nuk bëhet nëpërmjet portaleve e as me bamirësi, por me një program të qartë subsidiariteti për familjet më në nevojë. E kjo është punë e qeverisë e cila duhet të kujdeset për qytetarët e saj që jetojnë në kushte më të rënuara ekonomiko-shoqërore.

Shohim se shumë familje e fëmijë kanë vështirësi në ndjekjen e kurseve të shkollës online, sidomos në fshatrat e thella. Çdo fëmijë duhet të ketë të drejtën e arsimimit e garantuar nga Kushtetuta dhe t'i krijohen mundësi reale për ushtrimin e kësaj të drejte.

Së treti rifillimi i veprimtarive fetare

Për sa i përket rifillimit të veprimtarive fetare në Kishën Katolike u morën në shqyrtim mundësitë e krijuara nga hapat e ndërmarra nga organet kompetente dhe u vendos për një veprim gradual duke respektuar të gjithë hapat e nevojshëm. Do të punohet, në dialog me famulltarët dhe operatorët e tjerë kishtarë, si dhe në respektim të rregullave të vendosura për distancimin fizik, se cilat aktivitete mund të fillojnë e cilat jo.

Ne shprehim nga ana jonë gatishmërinë të bashkëpunojmë brenda mundësive tona që kjo kohë të kthehet në një kohë përkujdesjeje dhe shërbimi, një kohë e artë solidariteti dhe subsidiariteti, sidomos me shtresat më në nevojë.

Një logjikë solidariteti duhet të jetë revolucionari i vërtetë që ndodh në këtë situatë, në mënyrë që shoqëria jonë të konfigurohet si e tillë e të ketë në themel të vetin këto vlera kaq të rëndësishme.

Ne vazhdojmë të lartësojmë lutjet tona drejtuar Hyjit dhe Zojës së Këshillit të Mirë, Pajtores së Shqipërisë, që të mund të përballojmë me durim, këmbëngulje dhe dashuri këtë situatë të vështirë të krijuar nga Covid-19.

**Zyra e shtypit e
Konferencës Ipeshkvore të
Shqipërisë**



ËSHTË NJË DETYRË, SIDOMOS NDAJ ATYRE QË MË SË SHUMTI JANË TË RREZIKUAR: TË MOSHUARIT DHE FËMIJËT

*Thirrja – mesazh, ndaj korona virusit
Shkodër, 15/04/2020*

Vëllezër e motra,

Siç e dini, që kur ka filluar pandemia e COVID-19, kam përfituar prej çdo rasti për ta lutur së bashku me ju Hyjin e mëshirshëm, që të na lirojë prej këtij rreziku, që t'i ngushëllojë ata që janë prekur dhe që t'u japë pushimin e pasosur atyre që kanë vdekur prej saj.

Po ashtu, gjithmonë ju kam ftuar që të tregoni një kujdes maksimal, duke respektuar udhëzimet që na janë dhënë jo vetëm prej organeve kompetente, por edhe prej atyre që, si mjekët, punojnë në linjë të parë në luftën kundër këtij virusi.

Tani kthehem të ju për një ndërhyrje edhe më të fortë, për t'ju shprehur shqetësimin tim më të madh për shëndetin e popullit tonë, si edhe për t'ju porositur që të tregoni kujdesin e nevojshëm për të shmangur përhapjen e virusit në fjalë. Është një detyrim ndërgjegjeje që duhet ta ndiejmë të gjithë: në radhë të parë për respektin që kemi ndaj vetes sonë dhe për jetën që Hyji na ka dhuruar; e në radhë të dytë është edhe një detyrë morale ndaj të afërmit, sidomos ndaj atyre që më së shumti janë të rrezikuar: të moshuarit dhe fëmijët.

Është e vërtetë, pa një vaksinë do të jetë e vështirë që ta mundim këtë të keqe, dhe vetëm

shkencëtarët, me ndihmën e Hyjit, mund ta shpikin atë, por të gjithë kemi mundësi që të parandalojmë përhapjen e këtij virusi.

I kuptoj vështirësitë e një jete që na privon prej shumë gjërash, por e di edhe që populli ynë gjithmonë ka treguar një forcë dhe një guxim të madh në vështirësitë që historikisht i është dashur të përballojë.

Ky është momenti për ta treguar këtë guxim, duke i bërë thirrje disa karakteristikave që nuk na mungojnë: feja në Hyjin na jep forcën për t'i tejkaluar vështirësitë; solidariteti dhe mikpritja, tipike tonat, na japin rastin për t'i ndihmuar ata që janë më nevojtarë sesa ne, dhe ajo krenari e shëndoshë tipike shqiptare, që gjithmonë na ka ndihmuar për të dalë me kokën lart prej të gjitha situatave të vështira.

Të risjellim në mendje të gjitha masat mbrojtëse, që na kanë dhënë, dhe secili prej nesh të bëjë pjesën e vet, me bekimin e Hyjit.

Le që qëndrojmë në shtëpi!

Kam besim tek ju! Dhe se bashku, do t'ia dalim!

† Angelo Massafra O.F.M.

Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult



Prot. N. 67/2020
Shkodër, 21/05/2020

**PËR RIFILLIMIN E KREMTIMEVE
ME PJESËMARRJEN E POPULLIT TË HYJIT**

Të dashur Meshtarë, Rregulltarë, Rregulltare dhe Besimtarë,

Urime për të Kremten e Shelbuevit! Pas vendimit të Konferencës Ipeshkvnore të datës 19/05/2020 për rifillimin e kremtimeve liturgjike me praninë e besimtarëve, sot kam mbledhur Këshillin i Këshilltarëve dhe së bashku kemi vendosur këto udhëzimet konkrete.

Me anë të këtij komunikimi synohet metoda e rihapjes së kremtimeve liturgjike në Arqidioqezën tonë Shkodër – Pult dhe ju paraqesim disa norma të detyrueshme për të gjithë:

a. Të respektohet distancimi fizik: të paktën 1.5 metër larg njëri-tjetrit (*personat e të njejtës familje mund të rrinë së bashku*).

b. Të përdoren masat mbrojtëse (anti-covid) sipas udhëzimeve MSH.

c. Të parapëlqehen kremtimet jashtë, kur e mundëson koha, përndryshe të kihet kujdes që hapësirat e brendshme të kishës të jenë të ajrosura mirë: dyert të mbahen gjithmonë hapur.

d. Të dezinfektohen ambientet dhe gjerat e shenjta të përdorura gjatë kremtimit.

e. Të kihet kujdes që vendi i ujit të bekuar të jetë i zbrazur (mund të përdoret riti i pendesës si mundësi e stërpikjes së popullit me ujin e bekuar).

f. Të mos jepet dora, por të bëhet një gjest i dhënies së paqes.

g. Kungimi të jepet në dorë.

h. Ata që kanë probleme të theksuara shëndetësore janë të lutur të qëndrojnë në shtëpi dhe kremtimet t'i ndjekin nëpërmjet Radio Marisë Shqiptare dhe mediat.

U rikujtojnë besimtarëve rëndësinë e pjesëmarrjes fizike në kremtime, vlerën e sakramenteve dhe jetën e bashkësisë së krishterë, që tejkalon thjesht ardhjen në liturgji.

Të dashur, jam i bindur se do të ndiqni këto udhëzime me shumë kujdes për jetën tonë dhe për të tjerët. Parandalimi është ilaçi më i mirë për çdo sëmundje.

Ju falënderoj për zëmërsisht për durimin që keni patur dhe që do të keni dhe le të ecim me guxim, urtinë dhe shpresë: jeta është edhe në duart tona.

Ju përshëndes të gjithë dhe ju bekoj.

+ Angelo Massafra OFM
Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pult

Shënim: Këto udhëzime hynë në fuqi me datën 22/05/2020. Të lexohet në çdo Meshë më 24 maj, në Festën e Shelbuevit



MOTËR RAIMONDINA I KA SHËRBYER KËSAJ KISHE, ME NJË STIL TË PAZË DHE TË THJESHTË!

Letër Ngushëllimi për vdekjen e Motrës Raimondina Buscema

Shkëlqesi shumë e nderuar,
Imzot Carmelo Cuttitta,
Ipeshkev i Ragusa (Italia)

Ju bëj ngushëllimet e mia më të
sinqerta për vdekjen ditën e
djeshme të Motrës Raimondina
Buscema (në shekull Concetta),
lindur në Chiaramonte Gulfi
(Raguzë).

Motër Raimondina ka
shërbyer në këtë Dioqezë qysh në
momentet e para të formimit të
Hierarkisë kishtare në
Shqipëri deri pak kohë më
parë; në fakt, u pranua në
Dioqezën e Shkodrës në vitin
1997 prej paraardhësit tim të
ndjerë, Imzot Frano Illia.

Motër Raimondina i ka
shërbyer kësaj Kise, me një
stil të pazë dhe të thjeshtë, në
mënyra të ndryshme: formim
të më të vegjëlve, duke krijuar
një qendër ditore për fëmijët e



varfër, katekezë dhe rrobaqepësi të
shenjtë. Për këtë arsye, krahas
dhimbjes për vdekjen e saj dhe
lutjes sonë për shpirtin e saj,
falënderojmë Hyjin për dhuratën e
jetës së saj.

Shkëlqesi, ju lutem përcilljani
ngushëllimet e mia më të ndiera
edhe familjarëve dhe të afërmeve të
saj.

Meshën e shenjtë të ditës së
sotme, në orën 08.00, e kam
kremtuar për shpirtin e Motrës
Raimondina.

Zoti e shpërbleftë me jetën e
amshuar dhe i dhëntë pushimin e
pasosur.

Shkodër, më 03.04.2020

+ Angelo Massafra O.F.M.
Arqipeshkëv Metropolit
Shkodër-Pult



TË BASHKOHEMI SHPIRTËRISHT NË NJË DITË LUTJEJE, TË KRISHTERË, ISLAM E HEBRE

Kryetar i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë



Fort të dashur dhe të nderuar,

Hirësia e juaj H. Bujar Spahiu,
Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë,

Fortlumturia juaj Anastas Janullatos,
Kryepiskop i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë,

Hirësia juaj H. Dede Edmond Brahimaj,
Kryegjysh Botëror i Bektashinjve,

Pastor Ylli Doçi,
Kryetari i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë



Më 4 shkurt 2019 Papa Françesku dhe Imami i Madh i el-Ez'herit u takuan në Abu Dhabi për të firmosur Dokumentin mbi Vëllazëri Njerëzore. Kjo ngjarje dha rast që, me mbështetjen e Emirateve të Bashkuara Arabe, të formohej Komiteti i Lartë i Vëllazërisë Njerëzore (Higher Committee of Human Fraternity). Sot, ky Komitet përfshin udhëheqës që përfaqësojnë besimet e Krishtera, Islam dhe Hebre.

Para disa ditëve, ky Komitet i ka propozuar Papa Françeskut, që besimet e ndryshme, më 14 maj, të bashkohen shpirtërisht në një ditë lutjeje, agjërimit, dhe veprave bamirësie, që Zoti ta ndihmojë shoqërinë njerëzore për të kapërcyer pandeminë e koronavirusit. Papa Françesku ka pranuar me gëzim këtë propozim.

Prandaj ju sugjeroj t'i nxisni besimtarët tuaj që atë ditë, 14 maj, t'i drejtohen Zotit me lutje, agjërime dhe vepra bamirësie, që Ai, Zoti Krijues, të bekojë, shpëtojë dhe mbrojë popujt e Tij dhe të kthejë me mëshirë shikimin e Tij drejt nesh në këto kohë vuajtjeje.

Ju përshëndes vëllazërisht.

Mons. George Frendo
Kryetar i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë

Për dijeni:

Sh. T. Mons. Charles J. Brown, Nunci Apostolik në Shqipëri
Znj. Loreta Aliko, Kryetarja e Komitetit Shtetëror për Kultet



At Paulin Margjokaj

Epizode Historik

Botime Françeskane
Shkodër, 2020



**DROGA FAJDET
DHE LOJRAT E FATIT**

Komunitet Fetare,
Shkodër 2019



Kolec Traboini

**ODE
PËR SHKODRËN**

Pantheon
Tiranë 2019

KUMBONA E SË DIELËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë